



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 129

Tiranë – E hënë, 21 korrik 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe i ministrit të Financave nr. 1, datë 11.7.2025	Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025..... 19095
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 2, datë 10.7.2025	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive të zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, të ndryshuar..... 19105
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 21, datë 14.7.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 7, datë 17.7.2013, “Për mbrojtjen e kafshëve gjatë therjes”..... 19105
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 674, datë 10.7.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Kosovës..... 19106
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 675, datë 10.7.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 19107
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 680, datë 14.7.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 354, datë 21.12.2011, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi mbrojtjen e kafshëve gjatë transportit’”..... 19110
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 5.6.2025	“Arginert” sh.p.k. Tiranë kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 56411/15</i>)..... 19110

Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 12.6.2025	Agron Lamaj kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 12756/22</i>).....	19112
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 40, datë 17.6.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 457, datë 27.10.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 171, datë 9.11.2022, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 00-2024-1625 (195), datë 24.7.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	19115
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 408, datë 15.7.2025	Mbi miratimin e rregullave për kriteret dhe procedurat e krijimit të seksioneve dhe trupave gjykues	19124
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 123, datë 24.6.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 30 mw.....	19127
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 124, datë 24.6.2025	Mbi fillimin e procedurës, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Idi 2005” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 mw.....	19129
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 125, datë 24.6.2025	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	19130
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 126, datë 24.6.2025	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	19131
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 127, datë 24.6.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Parisol” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	19133
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 128, datë 24.6.2025	Mbi kërkesën e shoqërisë “GreenNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj.....	19135
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 129, datë 24.6.2025	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.4.2025 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Selishte’ sh.p.k.”...	19137

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 1, datë 11.7.2025****PËR KRITERET, PROCEDURAT,
TREGUESIT PËR SHPËRNDARJEN E
FONDIT TË GRANTIT TË BAZUAR NË
PERFORMANCË PËR BASHKITË PËR
VITIN 2025**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 12 të nenit 15 dhe pikës 6 të aneksit 9 të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, ministri i Financave dhe ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor

UDHËZOJMË:**I. Të përgjithshme**

1. Ky udhëzim përcakton kriteret, treguesit dhe procedurat e shpërndarjes së fondit të grantit të bazuar në performancë, i cili do t’u shpërndahet bashkive për vitin 2025.

2. Qëllimi i grantit të bazuar në performancë është:

a) të nxisë dhe fuqizojë bashkitë për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e qeverisjes së tyre, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, në të gjithë territorin ku bashkitë ushtrojnë veprimtarinë e tyre;

b) të përmirësojë veprimtarinë e strukturave administrative të bashkive dhe krijimin e një kulture të praktikave të mira në administratën publike vendore;

c) të nxisë dhe mundësojë ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet minimale ligjore, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) të nxisë performancën në një shkallë të lartë, duke krijuar një klimë konkurruese ku bashkitë përpiqen të përmirësojnë shërbimet e ofruara me standarde dhe në përputhje me nevojat specifike për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, në të gjithë territorin ku bashkitë ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

3. Të gjitha bashkitë kanë të drejtë të aplikojnë për të përfituar fonde nga granti i bazuar në performancë, në përputhje me afatet kohore,

kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Fondet e përfituara nga granti i bazuar në performancë përdoren nga bashkitë sipas nevojave të tyre, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime.

II. Përkufizime

1. “Granti i bazuar në performancë (GBP)” – është një mekanizëm i bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare dhe nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane dhe Qeveria e Suedisë, të përfaqësuara nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), bazuar në marrëveshjen e bashkëfirmosur nga palët sipas ligjit nr. 114/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin “Bashki të forta (BTF), faza 2”.

2. “AMVV” – është Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

3. “Donator” – është Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Ambasada e Zvicrës dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA).

4. “KVA” – është Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve të paraqitura nga bashkitë sipas përbërjes së përcaktuar në këtë udhëzim.

III. Treguesit për shpërndarjen e grantit të bazuar në performancë

1. Vlerësimi i treguesve do të bëhet bazuar mbi kriteret të qarta, të përcaktuara në anekset e këtij udhëzimi. Në rast se një nga kriteret e treguesit nuk plotësohet treguesi nuk do të vlerësohet.

2. Alokimi/ndarja e fondeve të GBP bëhet mbi bazën e këtyre kushteve:

a) përllogaritja e përafërt mesatare e vlerës së përgatitjes së planeve të përcaktuara si tregues performance për GBP;

b) proporcionaliteti me numrin e planeve të përgatitura dhe kriteret e plotësuar;

c) përmirësimi i menaxhimit financiar;

3. Bashkitë që kanë aplikuar për GBP dhe që vlerësohen se përmbushin treguesit e përcaktuar në këtë udhëzim, përfitojnë:

a) Një shumë që është proporcionale me peshën e caktuar për secilin tregues, si më poshtë:



Treguesi i GBP-së	Pesha (%)
Plani i Mbarështimit të Pyjeve	25
Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	10
Plani Vendor Social	10
Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	10
Plani Vendor i Integritetit	5
Plani Vendor i Barazisë Gjinore	5
Treguesit e matjes së performancës	5
Treguesi i detyrimeve të prapambetura	10
Treguesi i realizimit të buxhetit	10
Treguesi i taksës mbi pasurinë e paluajtshme	10

b) Një shumë shtesë të kufizuar, që përlogaritet proporcionalisht në bazë të fondeve të mbetura pa shpërndarë dhe peshës së treguesve të përmbushur.

IV. Procedura administrative për të përfutur nga granti i bazuar në performancë

1. AMVV-ja kryen detyrat e sekretariatit teknik për përgatitjen dhe shpërndarjen e fondit të GBP si dhe kujdeset për zbatimin e praktikave të të gjithë procedurave administrative sipas këtij udhëzimi.

2. AMVV-ja publikon në faqen zyrtare të internetit dhe njofton me shkrim të gjitha bashkitë për hapjen e thirrjes së aplikimit të GBP-së dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm për përmbushjen e treguesve të performancës të GBP-së.

3. Bashkitë dorëzojnë dokumentacionin që përmbush treguesit në AMVV jo më vonë se data 17.9.2025, ora 16:00. Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë bashkitë përcaktohet në aneksin 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Dokumentacioni që do të dorëzohet nga bashkitë duhet të përmbajë informacion për secilin tregues performance për të cilin do bëhet vlerësimi.

4. AMVV-ja këshillon në vijimësi bashkitë në procesin e përgatitjes së aplikimeve për GBP. Ajo organizon seanca informuese me bashkitë për të shpjeguar rregullat, procedurat, si dhe vendos në dispozicion në faqen zyrtare të internetit praktika dhe modele të ngjashme për hartimin e planeve vendore.

V. Vlerësimi i treguesve/planeve të performancës së grantit të bazuar në performancë

1. Vlerësimi i treguesve bëhet në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga bashkitë.

2. AMVV-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 1.

3. KVA përbëhet nga 5 pesë anëtarë/anëtare:

a) një anëtar/anëtare i propozuar nga ministri përgjegjës për pushtetin vendor;

b) një anëtar/anëtare nga ministria përgjegjëse për financat;

c) një anëtar/anëtare nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë, si dhe

d) dy anëtarë/anëtare të propozuar nga ministria përkatëse e cila mbulon fushën e përgjegjësisë së treguesit/planit të marrë në vlerësim;

Kryetar i KVA-së është përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për pushtetin vendor.

4. KVA-ja vlerëson dokumentacionin e dorëzuar nga secila bashki sipas kritereve të përcaktuara në anekset 2 dhe 3 që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe miraton rezultatin paraprak të vlerësimit. AMVV-ja publikon rezultatet e vlerësimit paraprak në faqen e saj zyrtare të internetit, dhe njofton bashkitë pjesëmarrëse me shkrim, duke i lënë 3 ditë kohë për të paraqitur komentet apo vërejtjet e tyre për vlerësimin e bashkisë përkatëse.

5. Pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 4 më sipër, brenda 2 ditëve, KVA-ja miraton vlerësimin përfundimtar të aplikimit për çdo bashki, dhe në vijim “AMVV” shpall tabelën përfundimtare të rezultateve të GBP-së, e bën atë publike në faqen zyrtare të internetit dhe njofton menjëherë bashkitë me shkrim.

6. Vendimet e KVA-së për vlerësimin përfundimtar të aplikimit për çdo bashki dhe tabela përmbledhëse e shpallur nga AMVV-ja i përcillen nga drejtori i përgjithshëm i AMVV-së Ministrisë së Financave, së bashku me listën për shpërndarjen e fondeve të grantit të performancës për çdo bashki.

7. Në këtë vendim që i dërgohet Ministrisë së Financave përcaktohet shuma edhe burimi i financimit të grantit të bazuar në performancë, për secilën prej bashkive përfituese.

8. Përfaqësues nga donatorët kanë të drejtë të jenë të pranishëm në të gjitha procedurat e administrimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të performancës së bashkive dhe të njihen me çdo dokumentacion të paraqitur. Përfaqësuesit/përfaqësueset e donatorit kanë të drejtë të shprehin qëndrimin e tyre me shkrim drejtuar KVA-së dhe AMVV-së për çdo fazë të procesit pa shkaktuar vonesa në aplikimin dhe vlerësimin sipas këtij udhëzimi.



VI. Procedura specifike për akordimin e grantit të bazuar në performancë

1. Granti i bazuar në performancë, për vitin 2025 ka burim financimi:

a) të brendshëm, në shumën 200 milionë lekë, si zë i veçantë i fondit të akorduar për buxhetin vendor si transfertë e pakushtëzuar sektoriale;

b) të huaj, në shumën 260 milionë lekë nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA).

A. Procedurat për akordimin e fondeve me burim financimi të brendshëm të grantit të bazuar në performancë të bashkitë përfituese

1. Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve pas marrjes së vendimit për bashkitë fituese njofton Ministrinë e Financave duke përcaktuar shumën përkatëse që përfiton çdo bashki për vitin 2025.

2. Ministria e Financave shpërndan fondin të bashkitë përfituese pas marrjes së njoftimit për vendimin e marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve.

3. Granti i performancës në vitin 2025 do të shpërndahet në bashkitë përfituese në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale.

4. Bashkitë kanë pavarësi të plotë të destinacionit të përdorimit të këtij fondi, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime.

5. Fondet e papërdorura nga granti i performancës së përfituar nga bashkitë në vitin 2025 me burim financimi transfertën e pakushtëzuar sektoriale, trashëgohen në vitin 2026 për t'u përdorur për të njëjtin destinacion/qëllim.

B. Procedurat për akordimin e fondeve me burim financimi të huaj të grantit të bazuar në performancë të bashkitë përfituese

1. Fondet e financimit të huaj për grantin e bazuar në performancë përfitohen në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, mbi bazën e marrëveshjes përkatëse midis Qeverisë së Zvicrës dhe asaj Shqiptare sipas ligjit nr. 114/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin “Bashki të forta (BTF), faza 2”, dhe menaxhohen bazuar në

udhëzimin nr. 10, datë 12.7.2024, “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, sipas skemës me thesar të plotë.

2. Disbursimi dhe ekzekutimi i fondeve të grantit të bazuar në performancë bëhet nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit (TSA) në Bankën e Shqipërisë (BSH).

3. Për të transferuar fondet nga donatori në TSA në mbështetje të marrëveshjes të miratuar me ligjin nr. 114/2024 të sipërcituar, struktura e përcaktuar për të menaxhuar fondet e financimit të huaj për grantin e bazuar në performancë në ministrinë përgjegjëse për financat, i dërgon zyrtarisht (me firmë të nëpunësit/nëpunëses të parë autorizues) donatorit (Ambasadës Zvicerane/SDC) formularin e identifikimit financiar (FIF), të plotësuar sipas formatit në aneksin nr. 2 të udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024, “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

4. Formulari i identifikimit financiar përveç referencave të TSA, në fushën REMARK përmban edhe kodin e produktit me emërtimin “Grant performance për bashkitë”, i cili çelët nga struktura përgjegjëse për Thesarin në qendër me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

5. SDC/Ambasada Zvicerane pasi merr formularin e identifikimit financiar të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për financat sipas pikës 3 më sipër, kryen disbursimin e financimit të huaj (në euro) duke vendosur në përshkrimin e transfertës bankare të dhënat e fushës REMARK të FIF.

6. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër krediton llogarinë ekonomike “106xxxx” pa specifikuar institucionin dhe ministrinë e linjës, bazuar në njoftimin e Bankës së Shqipërisë.

7. Akordimi i grantit të bazuar në performancë të bashkitë, mbështetet në vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Grantit të Bazuar në Performancë, vendim i cili në momentin e përzgjedhjes së bashkive përfituese i dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Financave dhe bashkive nga AMVV-ja.

8. Bashkitë fituese pasi janë informuar për vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve bëjnë me dije Këshillin Bashkiak (KB), i cili, në përputhje të plotë me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të



ndryshuar, dhe ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, merr vendimin për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të këtij fondi.

9. Pas marrjes së vendimit nga KB-ja, bashkitë i dërgojnë ministrisë përgjegjëse për financat vendimin e KB për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të këtij fondi, duke kërkuar çeljen e kodit të produktit/projektit për të cilin do përdoret ky fond.

10. Bashkitë kanë pavarësi të plotë të destinacionit të përdorimit të këtij fondi, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime.

11. Ministria e Financave, pas marrjes së vendimit të KB-së dhe kërkesës për çelje kodi bëjnë të mundur çeljen e kodit të produktit/projektit në SIFQ me qëllim më pas transferimin e fondit duke debituar kod institucioni 0000000, ministri linje 00, llogari ekonomike 106xxxx dhe kredituar kod institucioni kodin e bashkisë përkatëse, kod ministrie linje 00, dhe kodin përkatës të produktit/projektit bazuar në kërkesën e bashkive përkatëse.

12. Alokimi i fondeve për shpenzim bëhet me kapitull 02 “Financimi i huaj”.

13. Fondi i pashpërndare në TSA gjatë vitit buxhetor, shpërndahet në vitin buxhetor pasardhës për të njëjtin qëllim, vetëm me vendim të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve.

14. Gjendja e fondit të prokuruar dhe të papërdorur nga bashkitë në fund të vitit buxhetor trashëgohet në vitin buxhetor pasardhës dhe përdoret për të njëjtat projekte/produkte për të cilin është prokuruar.

15. Gjendja e fondit të ngelur tepriçë nga procesi i prokurimit përdoret nga bashkitë për qëllime të tjera që ato gjykojnë dhe vendosin me vendim të këshillit bashkiak.

VII. Monitorimi, raportimi dhe auditimi i grantit të bazuar në performancë

1. Bashkitë mbajnë dhe ruajnë evidencë të plotë të përdorimit të grantit me burim financimi buxhetin e shtetit dhe nga donatorët, dhe raportojnë pranë Ministrisë së Financave mbi progresin e projekteve.

2. Ministria e Financave, bazuar në raportimet e bashkive publikon përdorimin e fondeve të GBP-së. Raportet u dërgohen donatorëve nga Ministria e Financave.

3. Të gjitha fondet e financuara përmes GBP-së i nënshtrohen auditimit sipas legjislacionit në fuqi.

Auditimi realizohet nga institucione të pavarura të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

4. Donatorët kanë të drejtë të kryejnë monitorime në terren dhe të kërkojnë me shkrim auditimin e përdorimit të fondeve grant të dhëna sipas këtij udhëzimi, për raste të veçanta, kur shumat e grantit është më e madhe se 4 milionë lekë, e përdorur në një projekt të vetëm. Në këto raste, auditimi mund të kryhet nga subjekte të angazhuara posaçërisht nga donatorët e grantit dhe shpenzimet e auditimit në këto raste mbulohen nga donatorët.

VIII. Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe bashkitë për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Institucionet e përfshira në KVA të parashikuara sipas pikës 3 të kreut V të këtij udhëzimi dhe aneksit 3, të dërgojnë me shkresë zyrtare pranë AMVV-së emrat e përfaqësuesve/përfaqësueseve të tyre brenda 5 ditëve pune nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

3. Pjesë integrale e këtij udhëzimi janë anekset, bashkëlidhur si më poshtë:

Aneksi 1: “Afatet kohore për procedurën e aplikimit, shpërndarjes dhe përdorimit të GBP-së”;

Aneksi 2: “Vlerësimi nga AMVV-ja i dokumentacionit të paraqitur nga bashkitë”;

Aneksi 3: “Vlerësimi nga KVA-ja i cilësisë së planeve të paraqitura nga bashkitë dhe treguesve financiarë të performancës”;

Aneksi 4: “Përlllogaritja e shumave që përfitojnë bashkitë”.

4. Shpërndarja e GBP-së për vitin pasardhës do të rregullohet me dispozita shtesë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

MINISTËR I SHTETTIT
PËR PUSHTETIN VENDOR
Arbjan Mazniku



ANEKSI 1

AFATET KOHORE PËR PROCEDURËN E
APLIKIMIT, SHPËRNDARJES DHE
PËRDORIMIT TË GBP-së

- Periudha e përgatitjes për aplikime nga bashkitë: deri më 17 shtator 2025
- Ofrimi i mbështetjes për bashkitë (trajnim, shembuj): deri më 17 shtator 2025
- Vlerësimi i aplikimeve: shtator 2025
- Miratimi i bashkive fituese: shtator–tetor 2025
- Alokimi i fondeve: tetor–nëntor 2025
- Përfshirja në buxhetin vendor: tetor–nëntor 2025
- Monitorim dhe raportim: fillon nga dhjetor 2025

ANEKSI 2

VLERËSIMI NGA AMVV-ja I
DOKUMENTACIONIT TË PARAQITUR
NGA BASHKITË

- AMVV-ja verifikon dokumentacionin e paraqitur nga bashkitë, duke kontrolluar saktësinë e tyre dhe të dhënave që përmban.

- Për GBP-të e vitit 2025, treguesit quhen të plotësuar nëse përputhen me afatet si më poshtë:

1. Një Plan Mbarështimi Pyjesh i miratuar nga MTM-ja në periudhën 1 janar – 17 shtator 2025. Për këtë tregues do të merret parasysh edhe vetëm një ekonomi pyjore.

2. Një Plan Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës sipas legjislacionit në fuqi, në periudhën 1 janar 2025 – 17 shtator 2025.

3. Një Plan Social Vendor i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 1 janar – 17 shtator 2025.

4. Një Plan Vendor i Arsimit Parauniversitar i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 1 janar – 17 shtator 2025.

5. Një Plan Vendor i Integritetit i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 1 janar – 17 shtator 2025.

6. Një Plan Vendor i Barazisë Gjinore i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 1 janar – 17 shtator 2025.

7. Bashkia ka raportuar treguesit e matjes së performancës për vitin e referencës 2024 në përputhje me kërkesat e paraqitura në këtë udhëzim, të ndara në tre nëntregues: (i) bashkia ka raportuar treguesit brenda muajit korrik 2025; (ii) bashkia ka raportuar të gjithë treguesit e matjes së performancës; (iii) i gjithë stafi i Njësisë së Performancës në Bashki ka ndjekur trajnimet për treguesit e matjes së performancës.

8. Niveli i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura me të paktën 30%, në periudhën referuese nga 31.12.2024 deri 30.6.2025.

9. Realizimi i Planit të Buxhetit të Bashkisë, realizimi faktik të buxhetit në 6-mujorin e parë të vitit 2025 ndaj planit vjetor për vitin 2025 jo më pak se 35%.

10. Niveli i realizimit të të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme më shumë se 20%, kundrejt vitit paraardhës.

- Dokumentacioni që duhet të paraqitet nga secila Bashki, për secilin tregues për GBP për vitin 2025, si dhe verifikimi që bën AMVV, është sipas tabelës vijuese:

Nr.	Treguesi i GBP-së	Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga Bashkia	Verifikimi që bën AMVV
1	Një Plan Mbarështimi Pyjesh i miratuar nga MTM-ja në periudhën 1 janar - 17 shtator 2025. (Për këtë tregues do të merret parasysh edhe vetëm një ekonomi pyjore).	Plani i Mbarështimit të Pyjeve për ekonominë pyjore të përzgjedhur nga bashkia përkatëse Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve, për ekonominë pyjore të përzgjedhur nga bashkia përkatëse Urdhri i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit që miraton Planin e Mbarështimit të Pyjeve për ekonominë pyjore të përzgjedhur nga bashkia përkatëse	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse Vendimi i Këshillit Bashkiak ka numrin e vendimit, datën e vendimit, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit bashkiak dhe nga sekretari i këshillit bashkiak, është i publikuar në fagen zyrtare të bashkisë. Urdhri përmban numrin e regjistrimit, datën e urdhrin e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, tregon miratimin e planit për ekonominë përkatëse pyjore.
1.	Një Plan Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve i miratuar nga Këshilli	Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse



	Bashkiak përkatës në periudhën 1 janar – 17 shtator 2025.	Vendimi i Këshillit të Qarkut për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve për bashkinë përkatëse. Lidhja e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse.	Vendimi i Këshillit të Qarkut ka numrin e vendimit, datën e vendimit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit të qarkut dhe nga sekretari i këshillit të qarkut, është i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
		Akti i konfirmimit të VKQ nga Prefekti	Akti konfirmon VKQ përkatëse
2.	Një Plan Social Vendor i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 1 janar - 17 shtator 2025.	Plan Social Vendor	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Social Vendor për bashkinë përkatëse. Lidhja e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse	Vendimi i Këshillit Bashkiak ka numrin e vendimit, datën e vendimit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit bashkiak dhe nga sekretari i këshillit bashkiak, është i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
		Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi	Procesverbali të jetë i nënshkruar sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme të këshillit bashkiak.
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti	Akti konfirmon VKB përkatëse
3.	Një Plan Vendor i Arsimit Parauniversitar i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 1 janar 2025 - 17 shtator 2025.	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar.	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar për bashkinë përkatëse Lidhja e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse.	Vendimi i Këshillit Bashkiak ka numrin e vendimit, datën e vendimit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit bashkiak dhe nga sekretari i këshillit bashkiak, është i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
		Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi	Procesverbali të jetë i nënshkruar sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme të këshillit bashkiak.
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti	Akti konfirmon VKB përkatëse
4.	Një Plan Vendor i Integritetit i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 1 janar 2025 - 17 shtator 2025	Plani Vendor i Integritetit	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor të Integritetit për bashkinë përkatëse. Lidhja e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse	Vendimi i Këshillit Bashkiak ka numrin e vendimit, datën e vendimit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit bashkiak dhe nga sekretari i këshillit bashkiak, është i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
		Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi	Procesverbali të jetë i nënshkruar sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme të këshillit bashkiak
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti	Akti konfirmon VKB përkatëse
5.	Një Plan Vendor i Barazisë Gjinore i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 1 janar 2025 - 17 shtator 2025	Plani Vendor i Barazisë Gjinore.	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor të Barazisë Gjinore për bashkinë përkatëse. Lidhja e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse.	Vendimi i Këshillit Bashkiak ka numrin e vendimit, datën e vendimit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit bashkiak dhe nga sekretari i këshillit bashkiak, është i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
		Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi.	Procesverbali të jetë i nënshkruar sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme të këshillit bashkiak.
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti.	Akti konfirmon VKB përkatëse.
6.	Bashkia ka raportuar të treguesit e matjes së performancës për	Raportimi i të dhënave për treguesit e matjes së performancës për vitin 2025.	AMVV-ja verifikon që të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë brenda afatit të



	vitin e referencës 2024 , të ndara në tre nëntregues: (i) Bashkia ka raportuar treguesit e matjes së performancës brenda afatit të përcaktuar ; (ii) Bashkia ka raportuar të dhëna për të gjithë treguesit e matjes së performancës ; (iii) I gjithë stafi i NJP-së i Bashkisë ka ndjekur trajnimet e treguesve të matjes së performancës të ofruara nga AMVV-ja.	Lista e plotë e stafit të Njesisë së Performancës.	përcaktuara në udhëzimet për ushtrimin e matjes së treguesve të performancës. AMVV-ja verifikon që të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë për të gjithë treguesit AMVV-ja verifikon emrat e stafit përkundrejt listëpranisë në trajnime.
7.	Bashkia ka shlyer detyrimet e prapambetura me të paktën 30%, në periudhën referuese, nga data 31.12.2024 deri në datën 30.6.2025.	Raporti i detyrimeve të prapambetura gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë.	AMVV-ja verifikon informacionin e dërguar nga Ministria e Financave. Bashkitë të cilat nuk kanë detyrime të prapambetura vlerësohen me të gjitha pikët për këtë tregues.
8.	Bashkia ka realizim faktik të buxhetit në 6-mujorin e parë 2025 ndaj planit vjetor për vitin 2025 jo më pak se 35%.	Raporti i të dhënave për planin dhe faktin e realizimit të buxhetit të bashkive, për periudhën referuese, gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë.	AMVV-ja verifikon informacionin e dërguar nga Ministria e Financave.
9.	Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me 20% në 6-mujorin e parë të 2025-s ndaj së njëjtës periudhë të 2024. Në këtë vlerësim nuk përfshihet taksa e transaksioneve mbi pasurinë e paluajtshme.	Raportimi i të dhënave nga bashkitë për realizimin e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme. Raporti i Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë.	DPTP-ja, pas verifikimit dhe analizimit të të dhënave të dërguara nga bashkitë dhe në përputhje me raportin e gjeneruar nga SIFQ-ja dërgon informacionin tek AMVV-ja.

ANEKSI 3

VLERËSIMI NGA KVA-ja I CILËSISË SË PLANEVE TË PARAQITURA NGA BASHKITË DHE TREGUESVE FINANCIARË TË PERFORMANCËS

- KVA-ja vlerëson planet vendore e treguesit e tjerë të paraqitura nga bashkitë, dhe verifikon se:

- Dokumentacioni i paraqitur iu referohet treguesve të GBP-së;
- Planet e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara të cilësisë;
- Mosplotësimi i qoftë edhe njërit prej kriterëve të cilësisë, tregon që kriteri i performancës (Plani) të konsiderohet jo i përmbushur.

- KVA-ja përbëhet nga:

- një anëtar/anëtare nga ministria përgjegjëse për pushtetin vendor;
- një anëtar/anëtare nga ministria e financave;
- një anëtar/anëtare nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë.

Dhe për secilin plan:

- dy anëtarë/anëtare nga ministria përgjegjëse për pyjet dhe për menaxhimin e mbetjeve;
- dy anëtarë/anëtare nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- dy anëtarë/anëtare nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- dy anëtarë/anëtare nga ministria përgjegjëse për administratën dhe antikorrupsionin.
- kriteret e cilësisë për secilin tregues janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Treguesi i performancës i GBP	Kriteret e cilësisë së planeve
1	Plani i Mbarështimit të Pyjeve	Në përputhje me udhëzimet/kërkesat e MTM
2	Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	Planet në fushën e menaxhimit të mbetjeve i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor, referuar nenit 2 të ligjit nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, të ndryshuar.
		Plani parashikon përqindjen e mbulimit të kostos nga tarifa
		Plani parashikon përqindjen e mbulimit me shërbim të (i) territorit, dhe/ose (ii) popullsisë
		Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit.



		Plani përmban një mekanizëm monitorimi
		Plani mbulon një periudhë 5-vjeçare
3	Plani Social	Plani përmban analizën e nevojave për shërbime sociale bazuar në: a) numrin e popullsisë; b) shkallën e papunësisë; c) numrin e përfituesve të Ndihmës Ekonomike; d) numrin e personave me aftësi të kufizuara; e) numrin e shërbimeve sociale të ofruara; të ndara sipas tipologjisë së shërbimeve; f) numri i përfituesve për çdo shërbim të ndara sipas gjinisë. Plani shpreh zgjerimin e hartës së shërbimeve, që ofron bashkia, me të paktën 1 shërbim për bashkitë me popullsi nën 10000 banorë, 4 shërbime për bashkitë me popullsi nga 10000-50000 banorë dhe 10 shërbime për bashkitë me popullsi mbi 50000 banorë. Plani përmban kalendarin e aktiviteteve për çdo vit, si dhe financimin e aktivitetit/shërbimit që specifikon burimin që mbështet (buxheti i bashkisë/buxheti kombëtar/donatorë). Plani përmban metodologjinë e monitorimit dhe njësinë e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të aktivitetit dhe treguesit e matjes së performancës së shërbimeve të kujdesit shoqëror. Plani mbulon një periudhë të paktën 3-vjeçare
4	Plani i arsimit parauniversitar	Përmban një plan masash për rritjen e pjesëmarrjes dhe sigurimin e gjithëpërfshirjes në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Plani përmban analizën dhe shpërndarjen e infrastrukturës arsimore në territorin e bashkisë Plani përmban analizën dhe shpërndarjen e stafit arsimor në territorin e bashkisë Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit. Plani përmban një mekanizëm monitorimi Plani duhet të mbulojë një periudhë të paktën 3-vjeçare
5	Plani i Integritetit	Plani është në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030 Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit. Plani përmban një mekanizëm monitorimi Plani duhet të mbulojë një periudhë të paktën 3 vjeçare
6	Plani i barazisë gjinore	Plani të përmbajë të paktën një paketë emergjence për viktimat e dhunës me masat dhe buxhetin e nevojshëm. Plani të përmbajë masa dhe veprime që parashikohen bazuar në SKBGJ 2021-2030. Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit. Plani përmban një mekanizëm monitorimi Plani duhet të mbulojë një periudhë të paktën 3-vjeçare
7	Treguesit e matjes së performancës	Të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë brenda afatit të përcaktuar në këtë udhëzim. Të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë për të gjithë treguesit e matjes së performancës. Gjithë stafi i NJP-së i Bashkisë ka ndjekur trajnimet e treguesve të performancës.
8	Bashkia ka shlyer detyrimet e prapambetura me të paktën 30 %, në periudhën referuese	Niveli i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në periudhën e vlerësimit kundrejt periudhës referuese është mbi 30%.
9	Bashkia ka realizim faktik të buxhetit në 6-mujorin e parë 2025 ndaj planit vjetor për vitin 2025 jo më pak se 35%.	Realizimi i buxhetit për periudhën referuese kundrejt planit vjetor të buxhetit është në nivelin mbi 35%.
10	Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me 20%.	Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me 20% në 6-mujorin e parë të 2025-s ndaj së njëjtës periudhë të 2024. Në këtë vlerësim nuk përfshihet taksa e transaksioneve mbi pasurinë e paluajtshme.



ANEKS 4 PËRLLOGARITJA E SHUMAVE QË PËRFITOJNË BASHKITË

- Fondi i GBP-së shpërndahet për çdo bashki sipas një sistem matjeje të performancës që vlerëson përmbushjen e treguesve të vendosur.
- Bashkive që përmbushin treguesit e GBP-së në vitin 2025 do t'u shpërndahet:
- Një shumë që është proporcionale me peshën e caktuar për secilin tregues, si më poshtë:
- Një fond shtesë që përllogaritet proporcionalisht në bazë të fondeve të mbetura dhe treguesve të përmbushur.
- Shumat fikse për vitin 2025 janë sipas tabelës së mëposhtme.

Nr.	Treguesit e performancës 2025	Pesha e treguesit të matur	Shumat (në lekë) referuese për treguesit për 61 bashki	Shumat (në lekë) referuese për treguesit për 1 bashki
	Fondi GBP gjithsej	100%	460,000,000	7,540,984
1	Plani i Mbarëshimit të Pyjeve	25%	115,000,000	1,885,246
2	Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	10%	46,000,000	754,098
3	Plani Social vendor	10%	46,000,000	754,098
4	Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar	10%	46,000,000	754,098
5	Plani Vendor për Barazinë gjinore	5%	23,000,000	377,049
6	Plani i Integritetit	5%	23,000,000	377,049
7.1	Treguesit e matjes së performancës raportuar në kohë	2%	9,200,000	150,820
7.2	Treguesit e matjes së performancës raportuar të gjithë treguesit	2%	9,200,000	150,820
7.3	Stafi i Njësive të Performancës i trajnuar	1%	4,600,000	75,410
8	Treguesi i detyrimeve të prapambetura	10%	46,000,000	754,098
9	Treguesi i realizimit të buxhetit	10%	46,000,000	754,098
10	Treguesi i taksës mbi pasurinë e paluajtshme	10%	46,000,000	754,098

- Shpërndarja e fondit bëhet sipas dy komponentëve: (i) shuma fikse; (ii) shuma shtesë.
- Duke marrë një **shembull hipotetik** të plotësimit të treguesve nga bashkitë, shpërndarja është:
- **Supozojmë** se në thirrjen e GBP-së për vitin 2025 marrin pjesë 61 bashki. Pas vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar, dhe nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit të treguesve të performancës, përllogaritja e shumave të shpërndara është më poshtë:
- **Shuma fikse** e përcaktuar për secilin tregues për vitin 2025 shpërndahet sipas tabelës vijuese



Bashki pjesëmarrëse	TP 1	TP 2	TP 3	TP 4	TP 5	TP 6	TP 7	TP 8	TP 9	TP 10	Total Fonde / shuma proporcionale me TP
bashkia 1	1,885,246	754,098	754,098	754,098	377,049	377,049	377,049	754,098	754,098	754,098	7,540,984
bashkia 2		754,098	754,098		377,049	377,049	377,049	754,098	754,098	754,098	4,901,639
bashkia 3	1,885,246		754,098		377,049	377,049	377,049		754,098		4,524,590
bashkia 4		754,098					377,049	754,098		754,098	3,393,443
bashkia 5						377,049	377,049				754,098
bashkia 6	1,885,246	754,098		754,098		377,049	377,049		754,098		4,901,639
bashkia 7							377,049	754,098		754,098	1,885,246
bashkia 8		754,098	754,098		377,049		377,049		754,098		3,016,393
bashkia 9	1,885,246		754,098			377,049	377,049		754,098	754,098	4,901,639
bashkia 10	1,885,246	754,098	754,098	754,098		377,049	377,049	754,098			5,655,738
bashkia 11						377,049	377,049		754,098		1,508,197
bashkia 12							377,049		754,098		1,131,148
bashkia 13	1,885,246	754,098	754,098	754,098	377,049	377,049	377,049		754,098		6,032,787
bashkia 14		754,098	754,098			377,049	377,049	754,098			3,016,393
bashkia 15	1,885,246			754,098	377,049		377,049		754,098	754,098	5,278,689
bashkia 16		754,098	754,098	754,098		377,049	377,049	754,098	754,098		4,524,590
bashkia 17			754,098		377,049		377,049		754,098		2,262,295
bashkia 18				754,098		377,049	377,049	754,098	754,098	754,098	3,770,492
bashkia 19		754,098	754,098		377,049	377,049	377,049		754,098	754,098	4,147,541
bashkia 20	1,885,246				377,049	377,049	377,049		754,098		3,770,492
bashkia 21			754,098	754,098		377,049	377,049	754,098		754,098	3,770,492
bashkia 22				754,098	377,049	377,049	377,049		754,098		2,639,344
bashkia 23		754,098	754,098		377,049		377,049	754,098		754,098	3,770,492
bashkia 24	1,885,246	754,098	754,098		377,049	377,049	377,049		754,098	754,098	6,032,787
bashkia 25		754,098			377,049	377,049	377,049	754,098	754,098	754,098	4,147,541
bashkia 26			754,098	754,098		377,049	377,049		754,098	754,098	3,770,492
bashkia 27		754,098	754,098	754,098		377,049	377,049		754,098		3,770,492
bashkia 28	1,885,246	754,098			377,049		377,049				3,393,443
bashkia 29			754,098		377,049	377,049	377,049	754,098	754,098		3,393,443
bashkia 30		754,098		754,098		377,049	377,049	754,098	754,098	754,098	4,524,590
bashkia 31-61							11,688,524.59				11,688,525
Total fonde sipas komp	18,852,459	12,065,574	12,819,672	9,049,180	5,655,738	8,672,131	23,000,000	9,803,279	17,344,262	10,557,377	127,819,672

Shuma shtesë shpërndahet mes të gjitha bashkive pjesëmarrëse për vitin 2025, në mënyrë të përpjeshtme me treguesit e përmbushur, por në asnjë rast jo më shumë se katërfishi i shumës fikse të përfutur. Shpërndarja e shumës shtesë për rastin hipotetik që kemi marrë do të jetë sipas tabelës vijuese.

Bashkitë	Shuma proporcionale shtesë	Bashkitë	Shuma për çdo bashki (shuma fikse + shtesa)
bashkia 1	19,597,659.46	bashkia 1	27,138,643
bashkia 2	12,738,478.65	bashkia 2	17,640,118
bashkia 3	11,758,595.68	bashkia 3	16,283,186
bashkia 4	8,818,946.76	bashkia 4	12,212,389
bashkia 5	1,959,765.95	bashkia 5	2,713,864
bashkia 6	12,738,478.65	bashkia 6	17,640,118
bashkia 7	4,899,414.87	bashkia 7	6,784,661
bashkia 8	7,839,063.78	bashkia 8	10,855,457
bashkia 9	12,738,478.65	bashkia 9	17,640,118
bashkia 10	14,698,244.60	bashkia 10	20,353,982
bashkia 11	3,919,531.89	bashkia 11	5,427,729
bashkia 12	2,939,648.92	bashkia 12	4,070,796
bashkia 13	15,678,127.57	bashkia 13	21,710,914
bashkia 14	7,839,063.78	bashkia 14	10,855,457
bashkia 15	13,718,361.62	bashkia 15	18,997,050
bashkia 16	11,758,595.68	bashkia 16	16,283,186
bashkia 17	5,879,297.84	bashkia 17	8,141,593
bashkia 18	9,798,829.73	bashkia 18	13,569,322
bashkia 19	10,778,712.70	bashkia 19	14,926,254
bashkia 20	9,798,829.73	bashkia 20	13,569,322
bashkia 21	9,798,829.73	bashkia 21	13,569,322
bashkia 22	6,859,180.81	bashkia 22	9,498,525
bashkia 23	9,798,829.73	bashkia 23	13,569,322
bashkia 24	15,678,127.57	bashkia 24	21,710,914



bashkia 25	10,778,712.70	bashkia 25	14,926,254
bashkia 26	9,798,829.73	bashkia 26	13,569,322
bashkia 27	9,798,829.73	bashkia 27	13,569,322
bashkia 28	8,818,946.76	bashkia 28	12,212,389
bashkia 29	8,818,946.76	bashkia 29	12,212,389
bashkia 30	11,758,595.68	bashkia 30	16,283,186
bashkia 31–61	30,376,372.16	bashkia 31–61	42,064,897
Total sipas komponentit 2	332,180,328	Total	460,000,000

UDHËZIM

Nr. 2, datë 10.7.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 759, DATË 30.9.2024, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË, MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJEN E NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONEVE, OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës së Shqipërisë; të nenit 12, pika 4, dhe të nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, të ndryshuar, shkronja “a”, e pikës 2, të nenit 78, ndryshohet si më poshtë:

“a) të ketë diplomë të studimeve universitare master shkencor ose të barasvlershëm me të, në një nga drejtimet që ofron ofruesi publik i AFP-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACION
Blendi Gonxhja**

UDHËZIM

Nr. 21, datë 14.7.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 7, DATË 17.7.2013, “PËR MBROJTJEN E KAFSHËVE GJATË THERJES”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 68, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 7 datë 17.7.2013, “Për mbrojtjen e kafshëve gjatë therjes”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I, në pikën 4 pas shkronjës “s” shtohet shkronja “sh”, me këtë përmbajtje:

sh) “*Autoritet kompetent*” nënkupton:

i. Autoriteti kompetent qendror ose autoritetet kompetente për organizimin e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare;

ii. çdo institucion tjetër të cilit i është dhënë kjo përgjegjësi;

iii. autoritetet kompetente të shteteve të tjera.

2. Në aneksin I, të kreut I, në tabelën 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) titulli riformulohet “*Metodat atmosferike të kontrolluara*”;

b) pas numrit rendor 6 shtohet numri rendor 7 me këtë përmbajtje:



7	Trullosje me presion të ulët atmosferik	Ekspozimi i kafshëve të vetëdijshme ndaj dekompresionit gradual me reduktimin e oksigjenit të disponueshëm në më pak se 5%.	Pulat për mish deri në 4 kg peshë e gjallë. Therje, depopullim dhe situata të tjera.	Shpejtësia e dekompresionit. Kohëzgjatja e ekspozimit. Temperatura dhe lagështia e ambientit.	Pika 10.1–10.5
---	---	---	---	---	-------------------

3. Në aneksin I, të kreut II, pas nënpikës 9.5 shtohet pika 10 dhe me këtë përmbajtje:

10. Trullosja me presion të ulët atmosferik

10.1 Gjatë fazës së parë, shpejtësia e uljes së presionit atmosferik nuk duhet të kalojë një ulje të presionit nga niveli standard i presionit atmosferik në nivelin e detit nga 760 Torr në 250 Torr, për një periudhë jo më të shkurtër se 50 sekonda.

10.2 Gjatë fazës së dytë, duhet të arrihet një presion minimal standard në nivelin e detit prej 160 Torr brenda 210 sekondave të mëvonshme.

10.3 Kurba e presionit në funksion të kohës duhet të rregullohet për të siguruar që të gjitha shpendët të jenë trullosur në mënyrë të pakthyeshme brenda ciklit të kohës.

10.4 Dhoma duhet të testohet për rrjedhje dhe matësit e presionit duhet të kalibrohen para çdo seance veprimtarie dhe jo më rrallë se një herë në ditë.

10.5 Duhet të mbahen të dhëna për presionin absolut të vakumit, kohën e ekspozimit, temperaturën dhe lagështinë për të paktën një vit.

4. Në aneksin II, pas nënpikës 6.3, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

7. Trullosja me presion të ulët atmosferik.

7.1 Pajisjet për trullosjen me presion të ulët atmosferik do të dizajnohen dhe ndërtohen për të siguruar një vakum të dhomës që mundëson dekompresimin të ngadalhtë dhe gradual me uljen e oksigjenit të disponueshëm dhe mbajtjen e presionit minimal.

7.2 Sistemi duhet të jetë i pajisur për të matur vazhdimisht, shfaqur dhe regjistruar presionin absolut të vakumit, kohën e ekspozimit, temperaturën, lagështinë dhe për të dhënë një paralajmërim të qartë vizual dhe të dëgjueshëm nëse presioni devijon nga nivelet e kërkuara. Pajisja duhet të jetë e dukshme për stafin.

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i

Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1.9.2027.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 674, datë 10.7.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E KOSOVËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;



dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- i. 65°C në 39.8 sekonda;
- ii. 70°C në 3.6 sekonda;
- iii. 74°C në 0.5 sekonda;
- iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundje pseudopestit të shpendëve të shfaqur në shtetin e Kosovës janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	Kosovë	Gjilan*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Kosovës të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare të garantojnë origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 2.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 675, datë 10.7.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Lubelskie	Biała Podlaska	Janów Podlaski*
Pomorskie	Wejherowo	Luzino*
Wielkopolskie	Śrem	Brodnica*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Polonisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;



b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikiisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në



një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës

të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 633, datë 1.7.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 680, datë 14.7.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË URDHRIN NR. 354, DATË 21.12.2011,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
‘MBI MBROJTJEN E KAFSHËVE GJATË
TRANSPORTIT’”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 2, të nenit 72, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 354, datë 21.12.2011, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi mbrojtjen e kafshëve gjatë transportit’”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në nenin 2 ndryshohen përkufizimet me përmbajtje si më poshtë:

“d) Pikë Kontrolli Kufitar nënkupton një vend dhe ambientet që i përkasin atij, të përcaktuara nga autoriteti kompetent qendror për kryerjen e kontrolleve zyrtare në pikën e kontrollit kufitar të mbërritjes së parë në territorin e Republikës së Shqipërisë, për çdo ngarkesë të kategorive të kafshëve dhe mallrat që u nënshtrohen kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar.

e) “Autoritet Kompetent” nënkupton:

- Autoriteti Kompetent Qendror ose Autoritetet Kompetente për organizimin e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare;

- Çdo institucion tjetër të cilit i është dhënë kjo përgjegjësi;

- Autoritetet kompetente të shteteve të tjera.

g) Pikë dalje nënkupton një pikë kontrolli kufitar ose çdo vend tjetër të caktuar nga një autoritet kompetent, ku kafshët e transportuara largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar transportin e kafshëve

që nuk kryhet në lidhje me një aktivitet ekonomik dhe për transportin e kafshëve drejtpërdrejt në ose nga klinikat veterinare, sipas këshillës së një veterineri.”

Pas shkronjës “s” shtohet përkufizimi me këtë përmbajtje:

“sh) Veteriner zyrtar nënkupton veterinerin e emëruar nga një autoritet kompetent që është ose jo pjesë e stafit, i kualifikuar në mënyrë të përshtatshme siç duhet për të kryer kontrolle zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare.”

2. Neni 25 “Inspektimet dhe raportimet vjetore të autoritetit kompetent”, ndryshon si më poshtë vijon: *Autoriteti Kompetent i paraqet Autoritetit Kompetent Qendror deri më 31 gusht të çdo viti një raport vjetor për vitin e kaluar mbi inspektimet e kryera prej tyre për të verifikuar përputhjen me kërkesat e këtij urdhri. Raporti duhet të shoqërohet nga një analizë e mangësive kryesore të zbuluara dhe një plan veprimi për të adresuar këto mangësi.*

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1.9.2027.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 56411/15
ARGINERT SHPK TIRANË
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 13 maj 2025, si Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *President*,

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelar i Seksionit*,

Duke pasur parasysh:



kërkesën (nr. 56411/15) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”), më 10 nëntor 2015, nga një shoqëri tregtare, “Arginert” sh.p.k. Tiranë (“shoqëria kërkuese”), e krijuar në vitin 1995 dhe me seli në Tiranë, e përfaqësuar nga z. E. Zeneli, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar nga agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimet në lidhje me aksesin e shoqërisë kërkuese në Gjykatën Kushtetuese dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me të drejtën e shoqërisë kërkuese për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

2. Në një konflikt civil ndërmjet shoqërisë kërkuese dhe Bashkisë Tiranë në lidhje me detyrime kontraktuale, Gjykata e Lartë mori vendimin e saj më 27 tetor 2011.

3. Shoqëria kërkuese depozitoi një ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese, më 14 maj 2013. Ajo bashkëngiti një kopje informale të vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë.

4. Më 15 maj, Gjykata Kushtetuese i dërgoi shoqërisë kërkuese një shkresë në adresën e dhënë në ankimin e saj kushtetues. Gjykata Kushtetuese e ftoi shoqërinë kërkuese që të paraqesë një akt të noterizuar sipas të cilit avokati që e përfaqësonte atë ishte anëtar i Dhomës së Avokatisë dhe kishte të drejtën të përfaqësonte klientë përpara gjykatave më të larta, një kopje të noterizuar të ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, një kopje të noterizuar të ankimit në Gjykatën e Lartë dhe një kopje të noterizuar të vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë. Shkresa u kthye me shënimin që tregonte se marrësi “kishte lëvizur”.

5. Më 7 qershor 2013, Gjykata Kushtetuese bëri një përpjekje tjetër për t’i dorëzuar shkresën shoqërisë kërkuese në të njëjtën adresë dhe shkresa u kthye përsëri në Gjykatën Kushtetuese me shënimin “nuk u gjet”.

6. Një vërtetim i datës 1 tetor 2015 i nxjerrë nga Bashkia e Tiranës tregon që familja Dobi, ortak i shoqërisë kërkuese, kishte qëndruar që në vitin 1994 në adresën e dhënë nga shoqëria kërkuese në ankimin e saj kushtetues.

7. Në mars 2015, shoqëria kërkuese u interesua për çështjen e saj pranë Gjykatës Kushtetuese, dhe u njoftua që ajo nuk kishte paraqitur kopje të noterizuara të dokumenteve të kërkuara me ankimin e saj kushtetues. Shoqëria kërkuese i paraqiti dokumentet e kërkuara më 21 prill 2015 dhe Gjykata Kushtetuese regjistroi çështjen e shoqërisë kërkuese më 28 prill 2015.

8. Më 29 maj 2015, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankimin kushtetues të shoqërisë kërkuese të papranueshëm, sepse ishte depozituar jashtë afatit dy vjeçar, duke konsideruar datën 28 prill 2015 si datën e depozitimit të tij.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Kërkesa e qeverisë për të çregjistruar kërkesën sipas paragrafit 1 të nenit 37 të Konventës.

9. Qeveria paraqiti një deklaratë të njëanshme e cila nuk ofroi bazë të mjaftueshme për të gjetur që respektimi i të drejtave të njeriut siç përkufizohet në Konventë nuk kërkon që Gjykata të vazhdojë shqyrtimin e çështjes (neni 37 § 1 *in fine*). Gjykata refuzon kërkesën e Qeverisë për të çregjistruar kërkesën dhe në këto rrethana do të vijojë shqyrtimin e çështjes (shihni *Tahsin Acar kundër Turqisë* (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 26307/95, § 75, GJEDNJ 2003-VI).

B. Shkelja e pretenduar e paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës

10. Shoqëria kërkuese u ankua që zbatimi i rregullave të procedurës nga Gjykata Kushtetuese pengoi shqyrtimin në themel të ankimit të saj kushtetues dhe kështu cenoi të drejtën e saj për t’iu drejtuar gjykatës.

11. Gjykata theksoi që bazuar në një interpretim veçanërisht strikt të një rregulli procedural, gjykatat e brendshme me vendimin për të mos shqyrtuar në themel një çështje mund të cenojnë thelbin e së drejtës së kërkuesit për t’iu drejtuar gjykatës (shihni *Bëles dhe të tjerë kundër Republikës Çeke*, nr. 47273/99, § 51, GJEDNJ 2002 IX, dhe *Pérez de Rada Cavanilles kundër Spanjës*, 28 tetor 1998, § 49, *Raportet e Vendimeve* 1998-VIII). Rregullat që rregullojnë hapat formale që duhet të merren dhe afatet kohore që duhet të respektohen për depozitimin e ankimit synojnë të sigurojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe respektimin e parimit të sigurisë juridike në veçanti. Prandaj, rregullat në fjalë, ose mënyra e zbatimit të tyre nuk duhet të pengojë palët ndërgjyqësve që të përdorin një mjet juridik në



dispozicion (shihni *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, nr. 38366/97 dhe 9 të tjera, §§ 33 dhe 36, GJEDNJ 2000 I). Megjithatë, të interesuarit duhet të presin zbatimin e këtyre rregullave (shini *Muscat kundër Maltës* nr. 24197/10, § 44, 17 korrik 2012).

12. Në këtë çështje, Gjykata Kushtetuese menjëherë pasi mori ankimin kushtetues të shoqërisë kërkesë dërgoi një shkresë në adresën e saj të dhënë në ankim, me anë të së cilës i kërkoj që të dorëzonte kopje të noterizuara të dokumenteve të nevojshme. Megjithatë, dy përpjekje për të dorëzuar shkresën të shoqëria kërkuese në atë adresë nuk ishin të suksesshme, sepse emri i shoqërisë kërkuese nuk ishte në atë adresë. Në fakt, një vërtetim nga Bashkia e Tiranës tregon që ortakët e shoqërisë kërkuese qëndronin në atë adresë. Megjithatë, në ankimin e saj kushtetues, shoqëria kërkuese nuk ka përcaktuar që shkresat drejtuar asaj t'u dorëzohen ortakëve të saj.

13. Prandaj, Gjykata vlerëson që ankimi i shoqërisë kërkuese për mungesën e aksesit në Gjykatën Kushtetuese nuk ka të bëjë me një interpretim veçanërisht strikt nga gjykatat e brendshme të një dispozite procedurale si në çështjen *Bëleš*, cituar më sipër. Vetë shoqëria kërkuese krijoi një situatë ku shkresat e Gjykatës Kushtetuese të mos mund t'i dorëzoheshin (krahasoni *Miscat*, cituar më sipër, §§ 44 dhe 52; *Bogonos kundër Rusisë* (ven.), nr. 68798/01, 5 shkurt 2004; dhe *Mladenić kundër Kroacisë* (ven.), nr. 48485/99, 14 qershor 2001).

14. Prandaj, ky ankim është qartazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 5 qershor 2025.

Olga Chernishova
President

Úna Ní Raifeartaigh
Zëvendëskancelar në detyrë

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 12756/22

Agron LAMAJ kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 20 maj 2025, si Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *President*,

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelar i Seksionit*,

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 12756/22) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa"), më 24 shkurt 2022, nga shtetasi shqiptar z. Agron Lamaj ("kërkuesi"), i lindur në vitin 1954 dhe me banim në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria"), të përfaqësuar nga agjenti z. O. Moçka, avokat i përgjithshëm i shtetit, për ankimet në lidhje me pretendimin e mungesës së paanshmërisë së Gjykatës së Lartë dhe mungesës së aksesit në Gjykatën Kushtetuese sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me një gjobë vendosur ndaj kërkuessit, avokat, për abuzimin me të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë. Më së shumti kërkuesi u ankua sipas paragrafit 1 të nenit të Konventës se trupi gjykues i Gjykatës së Lartë që dëgjoi ankimin e tij për gjobën nuk ishte i paanshëm dhe se Gjykata Kushtetuese kishte shkelur të drejtën e tij për t'u drejtuar gjykatës.

FAKTE DHE PROCEDURA

A. Sfondi

2. Në nëntor 2020, kërkuesi përfaqësoi një klient i cili ishte i përfshirë në dy procese paralele që ishin në pritje para gjykatave të ndryshme dhe që lidheshin, përkatësisht, me çështje trashëgimie dhe pronësie të një pasurie.



3. Mosmarrëveshja mbi të drejtat e trashëgimisë së klientit ishte në proces para Gjykatës së Lartë që nga viti 2015.

4. Ndërkohë, në vitin 2019, klienti kishte ngritur një padi për njohjen e të drejtës së tij të pronësisë mbi një truall toke. Kjo padi ishte në proces para Gjykatës së Rrethit të Pogradecit.

B. Gjykata e Lartë

5. Më 20 nëntor 2020, kërkuesi i paraqiti Gjykatës së Lartë një kërkesë në emër të klientit të tij që, deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së trashëgimisë që ishte në proces para kësaj gjykate, të pezullohej shqyrtimi i mosmarrëveshjes së pronësisë që ishte në proces para Gjykatës së Rrethit të Pogradecit.

1. Vendimi i ndërmjetëm për të gjobitur kërkuesin

6. Më 8 janar 2021, Gjykata e Lartë e mbledhur me trup gjykues me gjyqtarë E. P., S. S., dhe I. P. mori një vendim të ndërmjetëm me të cilin refuzoi kërkesën. Ajo gjeti që kërkesa ishte abuzive sepse kërkuesi duhej ta dinte mirë që Gjykata e Lartë nuk kishte kompetencë pezullimin e proceseve përpara një gjykate rrethi.

7. Përveç refuzimit të kërkesës, Gjykata vendosi një gjobë prej 50,000 lekësh ndaj kërkuesit (përafërsisht 400 euro në atë kohë).

8. Vendimi i mësipërm u bazua në nenin 34/1 § 1 të Kodit të Procedurës Civile (“KPC”), pjesa përkatëse e të cilit lexon:

“Gjykata, në çdo shkallë të gjykimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive, ose të përsëritura dhe me keqdashje, ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur ose shtrembëruar me keqbesim ose faj të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjykimit, përveç kur në këtë Kod parashikohet ndryshe, gjobitjen e përgjegjësit në shumën nga 50 000 deri në 100 000 lekë.”

9. Gjithashtu gjykata u shpreh që çdo ankim kundër gjobës së vendosur do të shqyrtohej nga vetë Gjykata e Lartë.

2. Shqyrtimi

10. Më 24 shkurt 2021, kërkuesi apeloj duke argumentuar se procesi për trashëgiminë para Gjykatës së Lartë kishte zgjatur shumë, gjë që i kishte detyruar palët të fillonin proces paralel për të mbrojtur interesin e tyre. Ai shtoi se gjithçka që ishte

përpyetur të bënte ishte ta sillte këtë situatë në vëmendjen e gjykatës pa asnjë qëllim për të abuzuar me të drejtën e tij të ankimit.

11. Më 30 prill 2021, Gjykata e Lartë, e mbledhur me trup gjykues prej tre gjyqtarësh, përfshirë E. P. dhe I. P., të cilët kishin qenë gjithashtu pjesë e trupës gjykuese të 8 janarit 2021 (shihni paragrafin 6 më sipër), rrëzoi ankimin e kërkuesit kundër gjobës. Ajo gjeti që avokatëve u ishte kërkuar të ndihmonin gjykatën në trajtimin e çështjeve, jo ta mbingarkonin atë me kërkesa të paraqitura në keqbesim. Ajo shtoi që kërkuesi nuk kishte paraqitur argumente që justifikonin një ndryshim të vendimit të ndërmjetëm që vendoste gjobën.

C. Gjykata Kushtetuese

12. Më 16 korrik 2021, kërkuesi paraqiti një ankim kushtetues duke pretenduar zbatim të gabuar të nenit 34/1 të Kodit të Procedurës Civile. Ai shtoi se trupi gjykues i Gjykatës së Lartë i datës 30 prill 2021 nuk kishte qenë i paanshëm sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës, sepse përfshinte dy gjyqtarë të cilët më 8 janar 2021 kishin vendosur tashmë për gjobën (shihni paragrafët 6 dhe 11 më sipër).

13. Me një vendim të datës 25 tetor 2021, që iu njoftua kërkuesit më 16 nëntor 2021, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin kushtetues me arsyetimin se mosmarrëveshja e klientit të tij ishte ende në shqyrtim para gjykatave të zakonshme dhe kështu nuk ishin shteruar mjetet juridike. Gjykata u shpreh se gjoba nuk kishte një shkallë të mjaftueshme autonomie nga proceset kryesore për të justifikuar shqyrtimin kushtetues. Ajo shtoi se kërkuesi dhe klienti i tij mund të paraqesin një ankim kushtetues pasi të kenë përfunduar proceset për themelin.

14. Tre nga shtatë gjyqtarët paraqitën një mendim pakice duke u shprehur që proceset në lidhje me gjobën e kërkuesit ishin përfundimtare dhe gjykata duhej të kishte shqyrtuar ankimet e tij. Ata u mbështetën në një precedent të 8 prillit 2021 në të cilin gjykata kishte shpallur të pranueshëm një ankim të ngjashëm.

VLERËSIMI I GJYKATËS

15. Qeveria parashtroi, për aq sa ishte relevante, që ankimet ishin të papajtueshme *ratione materiae* me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës.

16. Kërkuesi nuk iu përgjigj kësaj linje argumentimi, por u ankua sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës se trupi gjykues i Gjykatës së Lartë i datës 30 prill 2021 nuk ishte i paanshëm dhe se



refuzimi i Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar ankimet e tij përbënte mohim të së drejtës së tij për t'iu drejtuar gjykatës.

17. Gjykata thekson se kërkuesi nuk pretendoi para gjykatave të brendshme ose Gjykatës për zbatimin e aspektit penal të paragrafit 1 të nenit 6 për faktet në fjalë. Prandaj, mbetet të përcaktohet nëse paragrafi 1 i nenit 6 ishte i zbatueshëm sipas aspektit të tij civil.

1. Parimet e zbatueshme

18. Parimet në lidhje me zbatueshmërinë e aspektit civil të paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës janë përmbledhur së fundmi në çështjen *Aktay kundër Turqisë* ((vendim), nr. 56064/16, 58000/16 dhe 15087/17, §§ 31-35, 9 shtator 2024).

19. Në veçanti, Gjykata thekson se rregullat që i mundësojnë një gjykatë të reagojë ndaj sjelljes së parregullt në proceset para saj janë një tipar i përbashkët i sistemeve ligjore të Shteteve Kontraktuese. Këto rregulla rrjedhin nga fuqia e domosdoshme e një gjykatë për të siguruar funksionimin e duhur dhe të rregullt të proceseve të veta (shihni, *mutatis mutandis*, *Gestur Jónsson dhe Ragnar Halldór Hall kundër Islandës* [DHM], nr. 68273/14 dhe 68271/14, §§ 81 dhe 89, 22 dhjetor 2020). Si Komisioni i mëparshëm ashtu edhe Gjykata kanë shqyrtuar zbatueshmërinë e aspektit civil të nenit 6 në kontekstin e gjobave të vendosura ndaj palëve në proceset ligjore për abuzim të procesit ose përcimim të gjykatës, dhe kanë konstatuar se këto gjoba synojnë të sigurojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe për këtë arsye kanë karakteristikat e sanksioneve procedurale që nuk përfshijnë përcaktimin e të drejtave ose detyrimeve civile (shihni *Aktay*, cituar më sipër § 35, me referenca të mëtejshme). Gjykata arriti në të njëjtin përfundim në çështjen *Andreiescu kundër Rumanisë* ((vendim), nr. 10656/05, §§ 6, 11 dhe 38, 9 prill 2013), e cila kishte të bënte me vendosjen e një gjobe ndaj një avokateje për mos respektim të detyrimeve procedurale në proceset gjyqësore ku ajo përfaqësonte klientët e saj.

2. Vlerësimi i Gjykatës

20. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse vendimet e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese përfshinin përcaktimin e “të drejtave civile” të kërkuesit sipas kuptimit të paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se nuk është roli i saj të vendosë nëse gjykatat e brendshme e kanë interpretuar dhe zbatuar saktë

nenin 34/1 të KPC-së dhe dispozitat e tjera përkatëse të brendshme në proceset e kontestuara.

21. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, Qeveria paraqiti argumente të hollësishme për arsyen pse vlerësonte që neni 6 § 1 të mos zbatohet në këtë çështje. Nga ana tjetër, kërkuesi nuk paraqiti asnjë pretendim në lidhje me zbatueshmërinë e aspektit civil të paragrafit 1 të nenit 6. Ai nuk shpjegoi se cilat, nëse kishte, nga të drejtat ose detyrimet e tij “civile” ishin vendosur në procesin që kishte çuar te gjoba (krahasoni me *Aktay*, cituar më sipër, §§ 41-44, ku Gjykata shqyrtoi ndikimin e një gjobe në praktikën e avokatit).

22. Gjykata nuk e injoron faktin që vendimi i ndërmjetëm i 8 janarit 2021 e ngarkoi kërkuesin me një detyrim financiar. Megjithatë, vetëm duke treguar që një mosmarrëveshje është me natyrë “financiare” nuk është në vetvete e mjaftueshme për të tërhequr zbatueshmërinë e paragrafit 1 të nenit 6 sipas aspektit të tij “civil” (shihni *Aktay*, i cituar më sipër, § 45, me referenca të mëtejshme). Gjykata ka konstatuar më parë se këto gjoba synojnë të sigurojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe për këtë arsye kanë karakteristikat e sanksioneve procedurale që nuk përfshijnë përcaktimin e të drejtave ose detyrimeve civile (shihni paragrafin 19 më sipër). Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se gjoba e kontestuar, shuma e së cilës nuk pretendohet se është e tepërt, nuk është në vetvete e mjaftueshme për të vënë në lëvizje aspektin civil të nenit paragrafit 1 të 6 të Konventës.

23. Nga kjo vijon se ankimet janë të papajtueshme *ratione materiae* me nenin 6 Konventës sipas kuptimit të paragrafit 3 (a) të nenit 35 dhe duhet të refuzohen në përputhje me paragrafin 4 të nenit 35 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 12 qershor 2025.

Olga Chernishova
President

Úna Ní Raifeartaigh
Zëvendëskancelar në detyrë



VENDIM
Nr. 40, datë 17.6.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 17.6.2025
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve kërkesën nr. 23 (M) 2024 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Mimoza Margjeka, përfaqësuar
nga avokate Margarita Kola, me prokurë të
përgjithshme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e
Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të
Organizuar, përfaqësuar nga prokuror Sotir Kllapi,
me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 457, datë
27.10.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së
Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
nr. 171, datë 9.11.2022, të Gjykatës së Posaçme të
Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të
Organizuar; nr. 00-2024-1625 (195), datë 24.7.2024
të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të
papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së
Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 27, 28, pika 3 dhe
42, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së
Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6 dhe 7 të
Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
(*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për
organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i
ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji,
mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të
kërkueses, Mimoza Margjeka (*kërkuesja*), e cila ka

kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit
të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër
Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e*
Posaçme), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe
diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është proceduar nga Prokuroria e
Posaçme në kuadër të procedimit penal nr. 186, datë
9.7.2020 (*procedimin penal nr. 186/2020*) për veprën
penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve
dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”,
të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit
Penal (KP).

2. Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë së
Posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për
Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja*
e Shkallës së Parë), me vendimin nr. 92, datë 5.9.2020,
ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal
“Arresti në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i
Kodit të Procedurës Penale (KPP). Masa është
zbatuar më datë 9.9.2020. Po ajo gjykatë, me
vendimin nr. 94, datë 12.9.2020, ka vendosur
vazhdimin e zbatimit të masës. Kundër këtyre
vendimeve ka ushtruar ankim kërkuesja.

3. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin
dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me
vendimin nr. 29, datë 1.10.2020, ka vendosur
miratimin e vendimeve nr. 92, datë 5.9.2020 dhe nr.
94, datë 12.9.2020 të GJKKO-së së Shkallës së Parë.
Ndërsa rekursi i ushtruar nga kërkuesja kundër këtij
vendimi nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë me
vendimin nr. 00-2020-486, datë 24.12.2020.

4. Në vijim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, pasi
është njohur me informacionin e prokurorit për
hetimet e kryera për procedimin penal nr. 186/2020,
në zbatim të nenit 246, pika 6, të KPP-së, me
vendimin nr. 403, datë 24.11.2020, ka vendosur
zëvendësimin e masës së sigurimit për kërkuesen në
“Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”.
Mbi bazën e ankimit të prokurorit, GJKKO-ja e
Apelit, me vendimin nr. 221, datë 17.12.2020, ka
ndryshuar masën e arrestit “Detyrim për t’u
paraqitur në Policinë Gjyqësore” dhe kërkuesja ka
vazhduar nën masën e sigurimit personal “Arresti në
shtëpi”.



5. Më datë 26.2.2021, Prokuroria e Posaçme ka dërguar kërkesën për kalimin e çështjes në gjyq. Kërkesa është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 37, datë 7.5.2021.

6. Gjatë kohës që çështja ka qenë në proces gjykimi, kërkesja, më datë 19.10.2022, mbështetur në nenin 263, pika 2, shkronja “b”, të KPP-së, ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit personal të arrestit në shtëpi, me argumentin se ishte tejkaluar afati ligjor 9-mujor i zbatimit të saj. Kërkesa është rrëzuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 457, datë 27.10.2022, me arsyetimin se masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” ishte e ndryshme nga ajo “Arresti në burg” dhe në zbatim të nenit 263, pika 2, shkronja “b”, të lidhur me nenin 267, pika 1, të KPP-së për atë masë zbatohet dyfishi i afateve të parashikuara nga neni 263 i KPP-së. Në rastin konkret, sipas gjykatës, afati ishte 18 muaj, i cili ende nuk ishte përmbushur, ndaj masa nuk e kishte humbur fuqinë e saj.

7. Mbi bazën e ankimit të kërkeses, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 171, datë 9.11.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkesja, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 13.12.2022.

8. Gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 69, datë 15.12.2022, ka vendosur deklarinin fajtores të kërkeses sipas akuzës dhe dënimin e saj me 4 vjet e 6 muaj burgim dhe *pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vnajtur të tij, duke e vënë kërkesen në provë për një periudhë kohe prej 3 vjetësh*. Në pikën 14 të dispozitivit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në zbatim të nenit 261, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, ka disponuar shuarjen e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”. Ky vendim është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 52, datë 12.12.2023. Ndaj vendimit të apelit ka ushtruar rekurs kërkesja dhe aktualisht çështja me nr. 59412-00319-00-2024, datë 21.5.2024 është në pritje për t’u gjykuar.

9. Ndërkohë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin për shuarjen e masës së sigurimit personal, me vendimin nr. 00-2023-8, datë 12.1.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se çështja ka mbetur pa objekt, pasi masa e sigurimit personal nuk është më në fuqi, për shkak se ndaj kërkeses është disponuar me vendim

penal të formës së prerë për dënimin e saj. Ky vendim i Gjykatës së Lartë është ankimuar nga kërkesja në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*).

10. Gjykata, me vendimin e saj nr. 17 të datës 13.3.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-8, datë 12.1.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë atij Kolegji. Gjykata ka vlerësuar se është cenuar e drejta e aksesit, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkeses, duke i lënë të pazgjidhura, në thelb, pasojat që kishin të bënin me një të drejtë themelore kushtetuese sikurse është kufizimi i lirisë personale. Gjykata ka arsyetuar se ndonëse Gjykata e Lartë ka zgjidhur formalisht çështjen, duke vendosur mospranimin e rekursit, ajo nuk ka bërë vlerësim në substancë të shkaqeve të tij, duke u mjaftuar me faktin se masa për të cilën kishte nisur procesi ishte shuar tashmë nga vendimi gjyqësor i dënimit. Pra, Gjykata e Lartë nuk ka bërë vlerësim nëse gjykatat më të ulëta për shkak të interpretimit të ligjit procedural penal i kanë cenuar ose jo lirinë personale kërkeses për periudhën që ajo pretendon se ka qëndruar në kufizim të lirisë përtej afatit të parashikuar nga ligji. Sipas Gjykatës, Gjykata e Lartë, duke mos kontrolluar ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit, ndonëse është ndodhur para pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit prej tyre, ka cenuar të drejtën e kërkeses për proces të rregullt ligjor.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në rishqyrtim në seancë publike me praninë e palëve çështjen dhe me vendimin nr. 00-2024-1625 (195), datë 24.7.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit nr. 171, datë 9.11.2022. Çështja e shtruar për diskutim nga ai kolegji lidhet me llogaritjen e kohëzgjatjes maksimale të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” dhe nëse duhet konsideruar kjo masë sigurimi e njëjtë me masën e paraburgimit ose e ndryshme me të. Në këtë kuptim, kolegji ka arsyetuar se afatet e parashikuara në nenin 263 të KPP-së lidhen me rastin e paraburgimit, pra të masës së sigurimit “Arresti në burg”, që nënkupton ndalimin dhe vendosjen në regjimin tradicional të burgjeve. Për të gjitha masat e tjera të sigurimit personal me karakter shtrëngues, përfshirë edhe masën e sigurimit “Arresti në shtëpi” vlen afati i kohëzgjatjes së tyre sipas parashikimit të nenit 267, pika 1, të KPP-së, pra që kohëzgjatja maksimale e saj është sa dyfishi i



afateve të paraburgimit. Vendosja në masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, sipas atij kolegji, përbën privim të lirisë, por nuk përbën as paraburgim në pritje të vendimit, por një regjim më pak të ashpër se sistemi tradicional i burgjeve. Nën këtë optikë, përcaktimet e nenit 237, pika 4, të KPP-së, që parashikon se rregullat e caktuara për paraburgimin vlejnë edhe për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi, lidhen me përshtatshmërinë e rregullave të caktuara për paraburgimin gjatë kohëzgjatjes së masës së sigurimit, pra që duhet të arsyetohet se pse është e nevojshme dhe proporcionale vendosja ose vijimi i kësaj mase. Ai kolegji më tej arsyeton se ndaj kërkuessës duhet të mbahen në konsideratë përcaktimet eksplicite të nenit 267 të KPP-së që lidhen me masat e tjera të sigurimit, përveç arrestit në burg, pra jo afati prej 9 muajsh i parashikuar nga neni 263 i KPP-së për veprën penale për të cilën akuzohet kërkuessja, por afati prej 18 muajsh (dyfishi) i parashikuar nga neni 267 i KPP-së. Gjithashtu, për të arritur në këtë përfundim në vendim elaborohen edhe përcaktimet e ligjit nr. 7942, datë 31.5.1995 “Për hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë’” (ligji nr. 7942/1995), si dhe të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (ligji nr. 81/2020), i cili termat “i paraburgosur” dhe “institucione të paraburgimit” i lidh me masën e sigurimit “Arresti në burg”. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se afatet e masave të sigurimit llogariten të ndara për çdo masë, prandaj ajo gjykatë ka konkluduar se gjykatat e faktit e kanë interpretuar drejt ligjin lidhur me afatet e shuarjes së masave të sigurimit.

12. Më datë 18.11.2024, kërkuessja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës më datë 24.1.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila më datë 4.2.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. **Kërkuessja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *liria personale*, e garantuar nga nenet 27 dhe 17 të Kushtetutës, si dhe KEDNJ-ja, pasi në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal

asaj i është kufizuar liria tej afateve ligjore, duke u mbajtur në burg pa ligj. Sipas saj, afati i masës së sigurimit personal është 9 muaj, pasi vepra penale për të cilën ajo është akuzuar parashikon dënimin me burgim deri në 10 vjet. Ndërkohë që nga data 26.2.2021, kur Prokuroria e Posaçme ka dërguar kërkesën për kalimin e çështjes në gjyq e deri më datë 19.10.2022, ditën e paraqitjes së kërkesës së saj për shuarjen e masës së sigurimit personal, kanë kaluar 386 ditë, duke mos llogaritur në këtë periudhë afatet e pezulluara të paraburgimit. Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar paligjshmëritë në vendimet e gjykatave më të ulëta, duke e interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin procedural penal. Kohëzgjatja e masës “Arresti në shtëpi” është e barabartë me kohëzgjatjen e afateve të paraburgimit, pra barazohet me paraburgimin dhe në këto kushte edhe përlllogaritja e kohëzgjatjes së këtyre afateve referon në nenin 263 të KPP-së dhe pezullimi i afateve të paraburgimit referon te neni 265 i KPP-së. Sipas saj, Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar rregullat e neneve 237, pika 4, ku përcaktohet se “*për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin*” dhe 263 të KPP-së. Gjithashtu, Gjykata e Lartë duhej të kishte dalë me një vendim njësoj për shkak të qëndrimeve të ndryshme të Kolegjit Penal lidhur me çështjen.

14. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

14.1 *Së pari*, kërkesa ka mbetur pa objekt sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi masa është shuar prej dy vjetësh dhe në një eventualitet të pranimit të kërkesës dhe prishjes së vendimeve të gjykatave të zakonshme, këto të fundit në rishqyrtim do të konstatonin mungesën e objektit.

14.2 *Së dyti*, kërkuessja nuk i ka argumentuar në nivel kushtetues pretendimet e saj. Pretendimi i kërkuessës për interpretimin që gjykatat e zakonshme u kanë bërë dispozitave procedurale nuk qëndron nga pikëpamja kushtetuese, pasi interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të zakonshme.

14.3 *Së treti*, kohëzgjatja dhe zëvendësimi i masës nuk përfshihen në sferën e kontrollit kushtetues. Kjo për arsye se jo çdo modalitet i zbatimit të masave mund të analizohet në zbatim të nenit 5 të KEDNJ-së.

14.4 *Së katërti*, vendimi nr. 58 i vitit 2014 i Gjykatës së Lartë, që citohet nga kërkuessja, i përket



një regjimi të ndryshëm juridik dhe praktika gjyqësore ka ndryshuar, siç është edhe rasti i vendimit nr. 111, datë 7.4.2022 të Gjykatës së Lartë, i cituar edhe nga vetë ajo, që i konsideron këto masa sigurimi të ndryshme dhe me regjim juridik të ndryshëm.

14.5 *Së pesti*, diferencat e parashikuara nga KPP-ja tregojnë se arresti në burg dhe ai në shtëpi janë dy masa krejt të ndryshme nga njëra-tjetra, për të cilat zbatohen afate të ndryshme. Këto dallime kanë të bëjnë me termin “paraburgim” që përdoret vetëm për arrestin në burg, fillimin e efekteve të masës, ku ato të arrestit në burg fillojnë nga çasti i ndalimit, ndërkohë për arrestin në shtëpi nga momenti i njohfimit të vendimit. Të ndryshme këto masa dalin edhe në nenin 236 të KPP-së, për sa i takon garancisë pasurore dhe atë 248 të KPP-së, që lidhet me pyetjen e personit të arrestuar. Po ashtu, ka dallim të qartë edhe në disa ligje si ai nr. 79, datë 25.6.2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” (*ligji nr. 79/2020*) dhe nr. 81/2020. Për sa i takon kohëzgjatjes, në nenin 263 të KPP-së legjislatori ka përdorur termin “paraburgim” duke iu referuar qartësisht vetëm masës së arrestit në burg. Edhe për sa u takon kushteve dhe kriterëve të aplikimit, dy masat rezultojnë të kundërta referuar nenit 230 të KPP-së, ndërkohë edhe neni 57 i KP-së “Llogaritja e paraburgimit” i referohet vetëm arrestit në burg.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si

dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit për të vënë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo do të thotë se individit mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në këtë drejtim ka prapësuar se kërkesa ka mbetur pa objekt sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi masa është shuar prej dy vjetësh dhe në një eventualitet të pranimit të kërkesës dhe prishjes së vendimeve të gjykatave të zakonshme, këto të fundit në rishqyrtim do të konstatonin mungesën e objektit.

18. Në kontekst të rrethanave të rastit në shqyrtim, Gjykata sjell në vëmendje qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në vendimin Hysa kundër Shqipërisë, datë 21.2.2023, sipas të cilit “*ndonëse në datën kur Gjykata Kushtetuese mori vendimin e saj, kërkesja kishte vuajtur tashmë kufizimin e lirisë së saj, ajo mund të përfitonte në mënyrë legjitime nga një shqyrtim kushtetues post facto dhe se një shqyrtim i plotë nga Gjykata Kushtetuese mund të kishte çuar në konstatimin se kërkesja ishte mbajtur në burgim në shkelje të së drejtës së saj për liri*” (*shih Hysa kundër Shqipërisë, datë 21.2.2023, § 83*). Në këtë drejtim, Gjykata thekson rëndësinë e veçantë që merr liria personale si një e drejtë themelore kushtetuese dhe substanciale, e cila nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 40, datë 18.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe mundësinë që ka kushdo për të gëzuar të drejtën për kompensim për burgim të padrejtë edhe në rastin e vuajtjes së arrestit në shtëpi tej afateve të përcaktuara nga ligji. Lidhur me këtë të drejtë, GJEDNJ-ja, në rastin e shqyrtimit të pretendimeve për parregullsi të procesit gjyqësor që ka sjellë kufizim të padrejtë të lirisë, është shprehur se “*përveç interesit moral në marrjen e rezultatis, një zgjidhje e tillë deklarative mund të hapte rrugën edhe për një kërkesë për kompensim mbi arsyet për burgim të paligjshëm sipas*



nenit 5 § 5 të Konventës (shih Hysa kundër Shqipërisë, datë 21.2.2023, § 83).

19. Gjithashtu, Gjykata konstaton se edhe në gjykimin kushtetues pararendës të zhvilluar prej saj (vendimi nr. 17/2024), pavarësisht faktit se edhe në atë rast Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e kishte konsideruar pa objekt rekursin për shkak të shuarjes së masës së sigurimit, Gjykata e mori në shqyrtim ankimin e kërkuësës sipas jurisprudencës së sipërpërmendur të GJEDNJ-së. Prandaj, në ndryshim nga sa parashtron subjekti i interesuar, Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae* edhe në rastin objekt shqyrtimi.

20. Për sa i takon kriterit për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, individ mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Detyrimin për përmbushjen e këtij kriteri Gjykata e ka vlerësuar si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur në themel procesin gjyqësor, ashtu edhe në rastin e vendimeve të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës. Për sa u takon këtyre të fundit, Gjykata ka pranuar se vendimet gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, i bëjnë ato vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës (shih vendimet nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Si të tilla Gjykata në jurisprudencën e saj ka konsideruar si masat e sigurimit personal “Arresti në burg” (shih vendimet nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese), ashtu edhe ato të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” (shih vendimet nr. 13, datë 13.3.2024; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se pretendimet e kërkuësës kanë të bëjnë me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë për shuarjen e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, për të cilën ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual. Prandaj Gjykata vlerëson se kërkuësja e ka përmbushur këtë kriter.

22. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.

8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në rastin konkret, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuësja ka përfunduar me vendimin e datës 24.7.2024 të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë më datë 18.11.2024, pra, brenda afatit ligjor 4-mujor.

23. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuësja në thelb ka pretenduar cenimin e lirisë personale të parashikuar nga neni 27 i Kushtetutës për shkak të interpretimit që gjykatat e zakonshme u kanë bërë dispozitave procedurale penale në lidhje me kohëzgjatjen maksimale të afateve të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”.

24. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se kërkuësja nuk i ka argumentuar në nivel kushtetues pretendimet e saj dhe se pretendimi i kërkuësës për interpretimin që gjykatat e zakonshme u kanë bërë dispozitave procedurale nuk qëndron nga pikëpamja kushtetuese, pasi interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të zakonshme.

25. Gjykata thekson se në parim interpretimi i ligjit është kompetencë e gjykatave të zakonshme, vendimet e të cilave nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si haptazi të paarsyeshme (shih vendimet nr. 67, datë 6.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, duke qenë se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe konkretisht me lirinë personale (shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese), në kushtet kur interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë është vënë në dyshim nga kërkuësja, si shkak për të cilin asaj i është cenuar liria personale e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, Gjykata çmon se prapësimi i subjektit të interesuar se interpretimi i ligjit është jashtë juridiksionit kushtetues nuk qëndron.

26. Mbi bazën e këtyre standardeve Gjykata në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë në themel të pretendimit të kërkuësës për cenimin e lirisë personale, duke iu referuar edhe arsyetimit të gjykatave të zakonshme, pasi sikurse ka pohuar në



jurisprudencën e saj (*shih vendimet nr. 1, datë 17.1.2025; nr. 19, datë 21.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, Gjykata bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, për sa kohë që në bazë të parimit të subsidiaritetit u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, duke qenë kjo Gjykatë mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e lirisë personale

27. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e lirisë personale, të garantuar nga nenet 27 dhe 17 të Kushtetutës dhe KEDNJ-ja, pasi në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal i është kufizuar liria tej afateve ligjore, duke u mbajtur në burg pa ligj. Sipas kërkueses, afati i masës së sigurimit personal është 9 muaj, pasi vepra penale për të cilën ajo është akuzuar parashikon dënimin me burgim deri në 10 vjet. Ndërkohë që afati i llogaritur prej saj nga data 26.2.2021, kur Prokuroria e Posaçme ka dërguar kërkesën për kalimin e çështjes në gjyq e deri më datë 19.10.2022, ditën e paraqitjes së kërkesës së saj për shuarjen e masës së sigurimit personal, është 386 ditë, duke mos llogaritur në këtë periudhë afatet e pezulluara të paraburgimit. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar paligjshmëritë në vendimet e gjykatave më të ulëta, duke e interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin procedural penal. Kohëzgjatja e masës së arrestit në shtëpi është e barabartë me kohëzgjatjen e afateve të paraburgimit, pra barazohet me paraburgimin dhe në këto kushte edhe përllogaritja e kohëzgjatjes së këtyre afateve referon në nenin 263 të KPP-së dhe pezullimi i afateve të paraburgimit referon te neni 265 i KPP-së. Sipas saj, Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar rregullat e neneve 237, pika 4, ku përcaktohet se “*për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin*” dhe 263 të KPP-së. Gjithashtu, Gjykata e Lartë duhej të kishte dalë me një vendim njësoj për shkak të qëndrimeve të ndryshme të Kolegjit Penal lidhur me çështjen.

28. Subjekti i interesuar ka prapësuar se kohëzgjatja dhe zëvendësimi i masës nuk përfshihen në sferën e kontrollit kushtetues. Kjo për arsye se jo çdo modalitet i zbatimit të masave mund të analizohet në zbatim të nenit 5 të KEDNJ-së. Gjithashtu, sipas tij, vendimi nr. 58 i vitit 2014 i

Gjykatës së Lartë, që citohet nga kërkuesja, i përket një regjimi të ndryshëm juridik dhe praktika gjyqësore ka ndryshuar siç është edhe rasti i vendimit nr. 111, datë 7.4.2022, i cituar edhe nga vetë ajo, që i konsideron këto masa sigurimi të ndryshme dhe me regjim juridik të ndryshëm. Po kështu, diferencat e parashikuara nga KPP-ja tregojnë se arresti në burg dhe ai në shtëpi janë dy masa krejt të ndryshme nga njëra-tjetra, për të cilat zbatohen afate të ndryshme. Këto dallime kanë të bëjnë me termin “paraburgim” që përdoret vetëm për arrestin në burg, fillimin e efekteve të masës, ku ato të arrestit në burg fillojnë nga çasti i ndalimit, ndërkohë për arrestin në shtëpi nga momenti i njoftimit të vendimit. Të ndryshme këto masa dalin edhe në nenin 236 të KPP-së, për sa i takon garancisë pasurore dhe atë 248 të KPP-së, që lidhet me pyetjen e personit të arrestuar. Po ashtu, ka dallim të qartë edhe në disa ligje si ai nr. 79/2020 dhe ligji nr. 81/2020. Për sa i takon kohëzgjatjes, në nenin 263 të KPP-së legjislatori ka përdorur termin “paraburgim”, duke iu referuar qartësisht vetëm masës së arrestit në burg. Edhe për sa u takon kushteve dhe kritereve të aplikimit, dy masat rezultojnë të kundërta referuar nenit 230 të KPP-së, ndërkohë edhe neni 57 i KP-së “Llogaritja e paraburgimit” i referohet vetëm arrestit në burg.

29. Kushtetuta në nenin 27 parashikon se liria nuk mund t’i hiqet askujt, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se kufizimi i saj mund të bëhet vetëm kur ka dyshime të arsyeshme se individ i ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shërkronja “c”, po aty*). Ndërsa neni 42 i saj sanksionon se liria nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor (*pika 1*) dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë (*pika 2*).

30. Gjykata rithekson se qëllimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një shoqëri demokratike. Në rastet që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë, është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara sipas ligjit dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të përmbushë standardin e “ligjshmërisë” të përcaktuar nga Kushtetuta (*shih vendimet nr. 24, datë 27.4.2023; nr. 39, datë 15.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).



31. Edhe GJEDNJ-ja është shprehur në jurisprudencën e saj se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveç rasteve të parashikuara në nenin 5 të KEDNJ-së dhe vetëm bazuar në ligj (*shih Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM]*, datë 28 janar 2008, § 67). Konventa në thelb i referohet legjislacionit të brendshëm dhe deklaron detyrimin për t'iu përshtatur rregullave materiale dhe procedurale, por, gjithashtu, çdo heqje lirie duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 5, pra të mbrojë individët nga arbitrariteti (*shih Bozano kundër Francës*, datë 18.12.1986, § 54; *Lukanov kundër Bullgarisë*, datë 20.3.1997, § 41).

32. Bazuar në sa më lart dhe në kontekstin e çështjes konkrete, Gjykata thekson se në rastin e masave të sigurimit që kufizojnë lirinë e individit, për mbrojtjen e individit nga arbitrariteti veprojnë disa garanci të nivelit ligjor, sipas të cilave ligji duhet të parashikojë llojin e masës së sigurimit dhe kohëzgjatjen e saj, ligji duhet të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij dhe masa e sigurimit, si dhe kohëzgjatja e saj duhet të jenë objekt i kontrollit gjyqësor. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, kushtet, kriteret dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP.

33. Lidhur me kufizimin e lirisë personale si pasojë e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, GJEDNJ-ja në praktikën e saj gjyqësore është shprehur se kjo masë konsiderohet, për nga shkalla dhe intensiteti i saj, si privim i lirisë në kuptim të nenit 5 të KEDNJ-së (*shih Nikolova kundër Bullgarisë (nr. 2)*, datë 30.9.2004, § 60; *Nănescu kundër Republikës së Moldavisë*, datë 15.7.2014, § 53; *Deljorgji kundër Shqipërisë*, datë 28.4.2015, § 75). Sipas GJEDNJ-së, është e vërtetë se në shumicën e rasteve arresti në shtëpi nënkupton më pak kufizime dhe një shkallë më të vogël vuajtjeje ose shqetësimi për të pandehurin sesa paraburgimi i zakonshëm në burg. Pavarësisht nga vendi, ndaj kërkuesit zbatohen të njëjtat kriteret për të gjithë periudhën e kufizimit të lirisë. Po sipas saj, nocionet “shkallë” dhe “intensitet” në praktikën gjyqësore, si kriteret për zbatueshmërinë e nenit 5 të KEDNJ-së, i referohen vetëm shkallës së kufizimeve të lirisë së lëvizjes, jo dallimeve në rehati ose në regjimin e brendshëm të paraburgimit (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë*, datë 5.7.2016, § 103, §§ 112–114).

34. GJENDJ-ja gjithashtu ka theksuar se për sa i takon përcaktimit të kohëzgjatjes së paraburgimit sipas nenit 5, paragrafi 3, të Konventës, periudha që duhet të merret në konsideratë fillon në ditën kur i akuzuari merret në paraburgim dhe përfundon në ditën kur përcaktohet akuza, edhe nëse vetëm nga një gjykatë e shkallës së parë, ose, ndoshta, kur aplikanti lirohet nga paraburgimi në pritje të procedurave penale kundër tij (*shih Idalov kundër Rusisë*, datë 22 maj 2012, § 112; *Kovyazin dhe të tjerë kundër Rusisë*, 17 shtator 2015, § 75). Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja nuk ka gjetur asnjë arsye për të miratuar një qasje të ndryshme në lidhje me arrestin në shtëpi (*shih Razvozzhayev dhe Udaltsov kundër Rusisë*, datë 19 shkurt 2020 § 213).

35. Nën dritën e standardeve të mësipërme dhe bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkueses, Gjykata do të analizojë nëse në rastin në shqyrtim interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për kohëzgjatjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” ka cenuar garancitë procedurale të lirisë personale të kërkueses, në kuptimin nëse interpretimi i ligjit ka qenë haptazi i paarsyeshëm, pra në atë masë sa rezultati në tërësi i kontrollit gjyqësor që gjykatat e zakonshme i kanë bërë kohëzgjatjes së masës së sigurimit është i padrejtë.

36. Në parantezë të analizës së këtij argumenti, Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në veçanti e Gjykatës së Lartë, për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 33*, datë 14.11.2022; *nr. 3*, datë 23.2.2016; *nr. 42*, datë 7.7.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, kur interpretimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka cenuar parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë çështja i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 63*, datë 20.11.2023; *nr. 19*, datë 4.4.2023; *nr. 19*, datë 7.7.2022 të Gjykatës Kushtetuese). Për këtë arsye, sikurse u theksua më sipër (*shih paragrafin 25 të vendimit*), në kushtet kur kërkuesja pretendon se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë i ka cenuar lirinë personale, Gjykata në vijim do të analizojë nëse interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë, në kuptimin e garancive procedurale të lirisë personale në lidhje me masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, është haptazi i paarsyeshëm.



37. Në këtë këndvështrim Gjykata vëren se krahas masës së sigurimit “Arresti në burg” (neni 238), KPP-ja si masë sigurimi që kufizon lirinë personale të individit parashikon edhe atë “Arresti në shtëpi”, sipas së cilës individit urdhërohet të izolohet në shtëpi (neni 237). Nisur nga standardet e jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata thekson paraprakisht se të dyja masat e sigurimit të arrestit, ajo në burg dhe ajo në shtëpi, konsistojnë në privim të lirisë personale të individit, pasi pavarësisht nga vendi ku zbatohet masa e sigurimit të arrestit, në burg ose në shtëpi, ato passjellin izolim të tij. Gjithashtu, duke qenë kufizimi i lirisë personale të individit *ultima ratio*, pra vetëm kur masat e tjera nuk mund të arrijnë të njëjtin qëllim, KPP-ja krahas garancive të shumta procedurale, që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor, me të cilën vendosen këto masa, për të mbrojtur individin nga arbitrariteti në heqjen e lirisë ka parashikuar edhe kohëzgjatjen maksimale të masave të sigurimit dhe të drejtën e individit që të kërkojë nga gjykata e zakonshme shuarjen e masës, pra lirinë në rast se procedimi penal vijon për një kohë të gjatë. Arsyeja e kësaj garancie procedurale lidhet me nevojën për të mbrojtur individin nga arbitrariteti në rastin e kufizimit të lirisë personale, në kuptimin që të detyrojë organin procedues – prokurorinë dhe gjykatën, që në rastin e akuzave penale ndaj individit me heqje lirie të kryejnë veprimet sa më shpejt të jetë e mundur, ashtu siç parashikon neni 28, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 3, i KEDNJ-së. Këto dispozita vënë theksin në mënyrë të posaçme në të drejtën e të arrestuarit për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

38. Konkretisht, referuar kohëzgjatjes së afateve të masave të sigurimit, pika 2 e nenit 263 të KPP-së “Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit” parashikon se paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë kanë kaluar afatet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” (në varësi të veprës penale për të cilën bëhet procedimi) pa u dhënë vendimi i dënimit në shkallë të parë. Ndërkohë që pika 1 e nenit 267 të KPP-së “Afatet e kohëzgjatjes maksimale të masave të tjera të sigurimit” përcakton se masat shtrënguese, të ndryshme nga paraburgimi, e humbasin fuqinë kur nga fillimi i zbatimit të tyre ka kaluar një kohë e barabartë me dyfishin e afateve të parashikuara nga neni 263 i KPP-së.

39. Në rastin në shqyrtim, kërkesja pas kalimit të 9 muajve nga vendosja e masës së arrestit në shtëpi, duke qenë se vendimi në shkallë të parë ende nuk ishte dhënë, bazuar në nenin 263, pika 2, shkronja “b”, të KPP-së (për shkak të veprës penale për të cilën po procedohej), ka paraqitur kërkesë për shuarjen e masës së arrestit në shtëpi. Referuar në tërësi përmbajtjes së vendimeve të gjykatave të faktit dhe në veçanti atij të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se nga interpretimi i dispozitave procedurale që lidhen me kohëzgjatjen maksimale të afateve të masave të sigurimit, ato kanë arritur në përfundimin se masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” nuk mund të barazohet me masën e sigurimit “Arresti në burg”. Konkretisht, Gjykata konstaton se gjykatat e faktit në thelb kanë arsyetuar se masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” është e ndryshme nga ajo “Arresti në burg” dhe se në zbatim të nenit 263, pika 2, shkronja “b”, që lidhet me veprën penale për të cilën procedohet kërkesja, e interpretuar në lidhje me nenin 267, pika 1, të KPP-së, për atë masë do të zbatohet dyfishi i afateve të parashikuara nga neni 263 i KPP-së. Sipas atyre gjykatave, afati në rastin konkret ishte 18 muaj, afat ky që ende nuk ishte përmbushur, ndaj për rrjedhojë masa nuk e kishte humbur fuqinë e saj.

40. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar se ndaj kërkeses rezulton të jetë caktuar masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” dhe jo “Arresti në burg”, sikurse parashikon neni 263 i KPP-së. Ai kolegji ka vlerësuar se do të duhet të mbahen në konsideratë përcaktimet eksplicite të nenit 267 të KPP-së, se masat shtrënguese, të ndryshme nga paraburgimi, e humbasin fuqinë kur nga fillimi i zbatimit të tyre ka kaluar një kohë e barabartë me dyfishin e afateve të parashikuara nga neni 263 i KPP-së. Në arsyetimin e saj ajo gjykatë argumenton se pavarësisht parashikimit të pikës 4 të nenit 237 të KPP-së, ku thuhet se “për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin”, e cila ngjan sikur ka kundërthënie me parashikimet e nenit 267, pika 1, të KPP-së, në qëllim parashikimet e këtyre dispozitave janë në harmoni dhe nuk dublojnë ose kundërshtojnë aspak njëra-tjetrën. Në rastin konkret, sipas interpretimit të bërë nga Gjykata e Lartë, përcaktimet e nenit 237, pika 4, të KPP-së lidhen me përshtatshmërinë e rregullave të caktuara për paraburgimin gjatë kohëzgjatjes së masës së sigurimit.



41. Gjithashtu, në arritjen e këtij konkluzioni, Gjykata e Lartë mbështetet te metodat e interpretimit të dispozitave dhe ligjit, si dhe në prezumimin se kohëzgjatja e zbatimit të masave të sigurimit përcaktohet në proporcion me shkallën e rëndësisë dhe të kufizimit të lirisë së individëve. Sipas saj, referuar metodës së interpretimit qëllimor (teleologjik) dhe atij literal (gjuhësor) nxirret konkluzioni se ligjvënësi ka synuar të diferencojë rëndësinë dhe peshën e masës së sigurimit shtrëngues “Arresti në burg” në raport me masat e tjera shtrënguese, duke përcaktuar shprehimisht kohëzgjatjen maksimale në një dispozitë të posaçme (nenin 263 të KPP-së). Qëllimi i kësaj dispozite, sipas Gjykatës së Lartë, del qartësisht si në titullin e saj, ashtu edhe në përmbajtje, ku përmendet vetëm fjala “paraburgim”. Me interpretim “*a contrario*”, nëse ligjvënësi do të kishte synuar që në këto afate të kishte përfshirë edhe masën “Arresti në shtëpi”, neni 263 i KPP-së do të duhej ta citonte atë në tekstin e kësaj norme. Gjithashtu, në arsyetim elaborohet edhe koncepti i kuptimit të termit “paraburgim”, duke u interpretuar sipas nenit 7 të ligjit nr. 7942/1995. Si argument tjetër plotësues për termin “paraburgim”, ajo gjykatë përdor edhe përcaktimet e neneve 3 dhe 21 të ligjit nr. 81/2020.

42. Në përfundim, ajo gjykatë ka vlerësuar se qëllimi i ligjvënësit në lidhje me afatet e kohëzgjatjes së çdo mase tjetër të ndryshme nga paraburgimi (arrest në burg) del që në titullin e dispozitës të nenit 267 të KPP-së “Afatet e kohëzgjatjes maksimale të masave të tjera të sigurimit”. Referuar kësaj analize, arsyeton ajo, arrihet në konkluzionin se neni 267 i KPP-së është i posaçëm për sa i përket kohëzgjatjes maksimale të masave të sigurimit të ndryshme nga paraburgimi, në raport me nenin 237 të KPP-së, që parashikon në tërësi modalitetet përmbajtësore dhe procedurale të caktimit të masës “Arresti në shtëpi”, duke përfshirë edhe mënyrën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së saj. Duke e konsideruar korpusin ligjor si një tërësi normash logjike e të ndërlidhura racionalisht dhe logjikisht me njëra-tjetrën, Gjykata e Lartë evidenton se nëse do të pranohej që afatet maksimale të “Arrestit në burg” (paraburgimi) do të ishin të njëjta me ato “Arresti në shtëpi”, do të rezultonte se rëndësia dhe shkalla e kufizimit të lirisë në një institucion paraburgimi dhe në shtëpi për personat nën hetim do të ishin të njëjta. Kjo hipotezë, arsyeton ajo në vijim, do të reflektonte paqartësi për nevojën për të parashikuar dy masa të

ndryshme në ligj, por me të njëjtën rëndësi dhe shkallë kufizimi të lirisë. Gjykata e Lartë thekson se masa e sigurimit “Arresti në burg” nuk konsiderohet e njëjtë me “Arresti në shtëpi”, duke analizuar dhe interpretuar frymën e pikës 1 të nenit 266 të KPP-së, përderisa kjo dispozitë parashikon mundësinë e caktimit të masave të tjera të sigurimit, pa asnjë përjashtim, kur kanë mbaruar afatet e paraburgimit, që nënkupton se masat e sigurimit janë të ndryshme ndërmjet njëra-tjetrës dhe nuk mund të përjashtojnë njëra-tjetrën për shkak të kalimit të afatit maksimal në zbatimin e tyre.

43. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ndonëse e gjendur përpara një rregulli ligjor, i cili literalisht parashikon se “*për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin*” (neni 237, pika 4, i KPP-së), pra me përmbajtje të qartë, duke përdorur disa metoda interpretimi ligjor, duket se ka krijuar në fakt normë të re procedurale (penale), sipas së cilës kohëzgjatja e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” është sa dyfishi i masës së sigurimit “Arresti në burg”. Duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka zhvendosur qëllimin e garancisë ligjore nga ajo për mbrojtjen e individit nga arbitrariteti në kufizimin e lirisë personale në rastet kur procedimi penal zgjat në mënyrë të paarsyeshme, në atë për t’i dhënë dyfishin e kohës organeve publike (në këtë rast prokurorisë dhe gjykatave) për të zhvilluar hetimet dhe gjykimin, duke tejkaluar qëllimin e ligjit. Në këtë pikë, Gjykata nuk vë në dyshim se masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” është e një shkalle më të vogël vuajtjeje sesa “Arresti në burg”, arsye për të cilën ligji procedural parashikon afate të ndryshme të konvertimit të tyre dhe konkretisht për arrestin në burg si masë sigurimi 1 ditë paraburgim konvertohet në 1.5 ditë burg (neni 57 i KP-së) dhe për arrestin në shtëpi 1 ditë arrest në shtëpi barazohet në 1 ditë burg (neni 7 i ligjit nr. 7942/1995). Gjithsesi, pavarësisht vendit ku zbatohet masa e sigurimit të arrestit, Gjykata, në të njëjtën linjë me jurisprudencën e GJEDNJ-së, vlerëson se ndaj individit duhet të zbatohen të njëjtat kritere për të gjithë periudhën e kufizimit të lirisë, përfshirë afatin e llogaritjes së kohëzgjatjes maksimale të tyre. Prandaj nuk ka arsye për të pasur një qasje të ndryshme edhe në lidhje me llogaritjen e këtyre afateve për arrestin në shtëpi në raport me arrestin në burg.

44. Edhe sipas Gjykatës së Kasacionit italian afatet maksimale të kohëzgjatjes të përcaktuara nga neni 303 i KPP-së, që ka të bëjë me kohëzgjatjen



maksimale të masave të sigurisë personale me heqje lirie, i referohen paraburgimit paraprak në përgjithësi, domethënë një kategori më të gjerë sesa paraburgimi paraprak në burg. Ky i fundit në lidhje me paraburgimin në përgjithësi qëndron në një raport të rregullit të posaçëm me atë të përgjithshëm. Si pasojë, kushtet e parashikuara nga dispozita e lartpërmendur zbatohen edhe për arrestin në shtëpi dhe nuk zbatohen ato të përmendura në nenin pasues 308 të KPP-së, që ka të bëjë me kohëzgjatjen maksimale të masave të tjera të ndryshme nga ato të sigurisë personale me heqje lirie, duke pasur parasysh se paragrafi i pestë i nenit 284 të KPP-së që parashikon arrestin në shtëpi e barazon atë me paraburgimin paraprak (*shih vendimin nr. 1536/1993*).

45. Parë në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se mënyra e interpretimit nga ana e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të neneve 263 dhe 267 të KPP-së në lidhje me pikën 4 të nenit 237 të tij, duke përcaktuar se për afatet e kohëzgjatjes maksimale të masave të sigurimit, afatet për arrestin në shtëpi nuk mund të barazohen me afatet për masën e sigurimit “Arrestin në burg”, jo vetëm nuk u përshtatet standardeve kushtetuese e konventore, por edhe nuk ka garantuar në mënyrë efektive lirinë personale. Ashtu sikurse ka pohuar Gjykata, dispozitat e KPP-së nuk mund të interpretohen nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në mënyrë të ngushtë, pasi të drejtat individuale duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimet 17, datë 13.3.2024; nr. 13, datë 7.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, duke qenë se kriteret dhe procedurat për caktimin dhe kontrollin gjyqësor të masave të sigurimit, përfshirë afatet e kohëzgjatjes së tyre, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e lirisë personale, Gjykata vlerëson se interpretimi i dispozitave procedurale penale nga ana e gjykatave të faktit dhe Gjykatës së Lartë nuk duket të jetë i arsyeshëm, duke i cenuar në këtë mënyrë kërkueses lirinë personale.

46. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e lirisë personale për shkak të interpretimit të dispozitave procedurale janë të bazuara sipas arsytimit të mësipërm, ndaj vendimet e të tria gjykatave të zakonshme duhet të shfuqizohen dhe kërkesa të pranohet. Megjithatë, në këtë rast, për shkak se masa e sigurimit “Arrestin në shtëpi” tashmë është shuar, Gjykata vlerëson të shprehet vetëm për konstatimin e cenimit të lirisë personale, në kushtet kur

pavarësisht konstatimit të shkeljes së kësaj lirie dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për kërkuesen.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 457, datë 27.10.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 171, datë 9.11.2022, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 00-2024-1625 (195), datë 24.7.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Konstatimin e cenimit të lirisë personale.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 17.6.2025.

Shpallur, më 16.7.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 408, datë 15.7.2025

MBI MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KRIJIMIT TË SEKSIONEVE DHE TRUPAVE GJYKUES

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 147, pika 1, dhe 147/a, pika 1, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 23, pika 7, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e



pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenet 61, pika 2, shkronja “ë”, 97, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

Neni 1 Objekti

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve dhe procedurës të krijimit të seksioneve, caktimi i gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues në Gjykatën e Lartë, si dhe gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të apelit.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtyre rregullave është krijimi i kushteve për specializim të trupës gjyqësore në funksion të rritjes së profesionalizmit, dhënies së drejtësisë pa vonesë, si dhe rritjes së besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

Neni 3 Parimet

1. Krijimi i seksioneve në gjykata realizohet në respektim të parimit të pavarësisë, procesit të rregullt ligjor, aksesit në drejtësi, sigurisë juridike, transparencës, profesionalizmit, fleksibilitetit dhe lëvizshmërisë të trupës gjyqësore, efikasitetit dhe objektivitetit.

2. Ndarja në seksione realizohet nëpërmjet gjetjes së një ekuilibri të drejtë midis nevojës për specializim të gjyqtarit si pjesë e trupës gjyqësore, ushtrimi i të drejtës për zhvillimin e karrierës së magistratit dhe garantimit të funksionalitetit dhe mbarëvajtjes së punës në gjykatë.

Neni 4 Specializimi i trupës gjyqësore

1. Specializimi i gjyqtarit/trupës gjyqësore mundëson marrjen/fitimin e njohurive dhe aftësive të thelluara brenda një fushe apo nënfushe specifike të së drejtës.

2. Në gjykatat në të cilat nuk është e mundur sipas ligjit të krijohen seksione, gjyqtarët e specializuar për shqyrtimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, gjykojnë çështje në përputhje me kreun III, pika 11, të vendimin nr. 554, datë 29.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore.

Neni 5 Krijimi i seksioneve

1. Këshilli i Gjykatës, pas marrjes së mendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve, vendos për krijimin e dy ose më shumë seksioneve në gjykatë, me vendim të arsyetuar.

2. Seksioni i gjykatës përbëhet nga së paku 6 gjyqtarë.

3. Vendimi për krijimin e seksionit i njoftohet menjëherë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Vendimi i Këshillit të Gjykatës botohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës.

Neni 6 Kriteret për krijimin e seksioneve

1. Vendimi për krijimin e seksionit, bazohet në analizën tërësore të kriterëve objektive të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Konsiderohen kriterë objektive:

a) numri i gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin efektivisht në gjykatë;

b) lloji i çështjeve;

c) numri i çështjeve të regjistruara në të paktën tri vitet e fundit;

d) ngarkesa e gjyqtarëve;

3. Në çdo rast në krijimin e seksioneve, Këshilli i Gjykatës merr në konsideratë efektet e ndryshimeve në legjislacionin material dhe procedural, dhe të administrimit gjyqësor që rrisin efikasitetin dhe cilësinë e drejtësisë.

Neni 7 Seksionet në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm

1. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm organizohen dhe funksionojnë në seksione.



2. Ndarja në seksione nënkupton ndarjen, por pa u kufizuar vetëm në, seksionin civil dhe penal, tregtar, familjar etj., sipas fushave të veçanta të së drejtës.

Neni 8

Seksionet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

1. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm organizohet dhe funksionon në seksione.

2. Ndarja në seksione nënkupton ndarjen, por pa u kufizuar vetëm, në seksionin civil dhe penal.

Neni 9

Seksionet në Gjykatën e Lartë

Rregullat për krijimin e Seksioneve (Kolegjeve) të Gjykatës së Lartë, zbatohen parashikimet e ligjit 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 10

Caktimi i gjyqtarit në seksion

1. Këshilli i Gjykatës vendos caktimin e gjyqtarit në seksionin përkatës, në përputhje me nevojat e gjykatës dhe pas marrjes së mendimit të gjyqtarit.

2. Si rregull, caktimi i gjyqtarit në seksion bazohet në vlerësimin tërësor të kriterëve të mëposhtme:

a) përvoja profesionale që lidhet me natyrën e çështjeve të gjykuara;

b) fusha e interesit të gjyqtarit;

3. Në rastin e procedurës së lëvizjes paralele, transferimit të përkohshëm apo ngritjes në detyrë sipas ligjit, Këshilli i Gjykatës cakton në seksion gjyqtarin e transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele, transferuar përkohësisht apo ngritur në detyrë, në përputhje me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor që specifikon fushën përkatëse të së drejtës.

4. Përjashtimisht nga rregullat e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, caktimi në seksion mund të kryhet nga Këshilli i Gjykatës, me vendim të arsyetuar, pavarësisht mendimit të gjyqtarit, për arsye objektive që lidhen me garantimin e funksionalitetit, mbarëvajtjes së punës në gjykatë dhe trajnimet e kryera brenda dhe jashtë vendit për një fushë të caktuar të së drejtës për të cilat konsiderohet gjyqtar i specializuar.

Neni 11

Caktimi i trupave gjykues në seksione

1. Këshilli i Gjykatës vendos për krijimin, caktimin e gjyqtarëve në seksione dhe përbërjen e trupave gjykues për çdo seksion në gjykatë, me vendim të arsyetuar.

2. Këshilli i Gjykatës sigurohet që trupi gjykues të ketë përbërje të tillë që garanton balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe fushën e tyre të interesit.

Neni 12

Ushtrimi i funksionit në seksion

1. Këshilli i Gjykatës, me qëllim garantimin e shpërndarjes së ngarkesës së barabartë ndërmjet gjyqtarëve, brenda njëres prej fushave të së drejtës civile ose penale, gjyqtari mund të shqyrtojë çështje të një seksioni të ndryshëm nga ai ku është caktuar, por gjithmonë brenda së njëjtës fushë të së drejtës ku bën pjesë seksioni.

2. Këshilli i Gjykatës, me qëllim garantimin e shpërndarjes së ngarkesës së barabartë ndërmjet gjyqtarëve, jashtë seksioneve sipas fushës së të drejtës civile ose penale, mund të caktojë përkohësisht, me vendim të arsyetuar, që një gjyqtar i caktuar në një seksion të shqyrtojë çështje të një seksioni të ndryshëm nga ai ku është caktuar, edhe jashtë fushës së të drejtës së seksionit përkatës.

Neni 13

Ndryshimi i seksionit

Këshilli i Gjykatës, pas marrjes së mendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve, me qëllim garantimin e funksionalitetit dhe mbarëvajtjes së punës në gjykatë, të drejtës së zhvillimit të karrierës dhe specializimit të magistratit, në respektim të parimit të fleksibilitetit dhe lëvizshmërisë së trupës gjyqësore, në përputhje me nevojat e gjykatës, vendos ndryshimin dhe kalimin e gjyqtarit nga një seksion në një tjetër brenda të njëjtës gjykatë.

Neni 14

Shkrirja e seksionit

1. Këshilli i Gjykatës, pas marrjes së mendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të gjykatës,



me vendim të arsyetuar, vendos shkrimin e seksionit në gjykatë.

2. Vendimi për shkrimin e seksionit, bazohet në analizën tërësore të kriterëve objektive, të lidhura me:

- a) ndryshimin e llojit dhe numrit të çështjeve;
- b) ngarkesën e gjyqtarëve.

3. Vendimi për shkrimin e seksionit i njoftohet menjëherë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Vendimi i Këshilli të Gjykatës botohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës.

5. Këshilli i Gjykatës, në çdo rast, merr në konsideratë efektet e ndryshimeve në legjislacionin material dhe procedural, si dhe praktikën e mira të administrimit gjyqësor që rrisin efikasitetin dhe cilësinë e drejtësisë.

Neni 15

Dispozita tranzitore

1. Këshilli i Gjykatës, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij akti, merr masa për plotësimin e kriterëve të trupës gjyqësore pranë një seksioni, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

2. Për efekt të ndryshimeve të seksioneve në zbatim të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të zbatohet rindarja e çështjeve gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

3. Ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për kryerjen e procedurave dhe zhvillimeve të nevojshme në sistemin e menaxhimit të çështjeve, me qëllim pasqyrimin e seksioneve, trupave gjykues dhe caktimin e gjyqtarëve në seksione.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi

VENDIM

Nr. 123, datë 24.6.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 30 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1841/1 prot., datë 17.6.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1841 prot., datë 10.6.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 30 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”,



“b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaron se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “c” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a”, “b” dhe “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “b” dhe “e”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 244, datë 30.4.2025, ka miratuar ndërtimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k.

- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kontratën nr. 4456 rep., nr. 2040 kol., datë 27.5.2025, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 30 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3038, Njësia Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k.

- Shoqëria është pajisur me VNM paraprake, lëshuar më 13.2.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Ndërtimi i centralit fotovoltaike centrali elektrik fotovoltaike “EZ-5 Solar Park 2, 30 mw”.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- **Germa “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit dhe për administratorin tjetër të saj.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- **Germa “b”:** Në kuadër të një informacioni shtesë, shoqëria duhet të sqarojë në rast se ka ndryshuar raporti i financimit nga ai i parashikuar në planin e biznesit dhe po ashtu duhet të japë sqarimet përkatëse për vlerën e financimit nga banka.

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- **Germa “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë të dhënat teknike në lidhje me jetëgjatësinë e centralit. (shtojca 2 në rregullore).

- **Germa “c”:** Shoqëria të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes me OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 30 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.



Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 124, datë 24.6.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS,
PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK, PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET
TË INSTALUAR 8.8 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1849/1 prot., datë 19.6.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1849 prot., datë 11.6.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 8.8 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në

sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren:

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaroi se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a” dhe “d”;

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a” dhe “c”;

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “a”, “c”, “d” dhe “e”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria është pajisur me miratimin paraprak nr. 1081/2 prot., datë 25.6.2024, dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 8.8 mw, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier”.

- Shoqëria është pajisur me miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresave të “OSSH” sh.a. nr. 2143/3 prot., datë 12.3.2024 dhe nr. 3554/1 prot., datë 11.4.2024.

- Shoqëria është pajisur me VNM paraprake, lëshuar më 7.11.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Parku fotovoltaik ‘TEKSOEN’”.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:



Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa “b”, duhet të depozitohet dëshmia e penaltetit për administratorin dhe vetë shoqërinë;

- germa “c”, shoqëria duhet të bëjë saktësimin përkatës në strukturë sa i përket administratorit të saj, si dhe të informojë nëse kjo strukturë është aktualisht funksionale apo do të bëhet e tillë në fazën e operimit të veprimtarisë së licencuar;

Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “b”, shoqëria duhet të saktësojë mjetet monetare që do të përdorë për financimin e projektit dhe të depozitojë këtë dokumentacion në ERE;

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës:

2.1, Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- germa “a”, shoqëria duhet të depozitojë një dokument teknik në lidhje me jetëgjatësinë e centralit;

- germa “b”, shoqëria duhet të depozitojë kontratën e nënshkruar me MIE-n.

- Rezultohet se shoqëria disponon një VNM të vlefshëm deri më datë 7.11.2026. Megjithëse në dokumentacionin e paraqitur (shtojca 2) është deklaruar se fillimi i punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaiik parashikohet gjatë viteve 2025–2026, por nuk janë paraqitur të dhëna të përditësuara, lidhur me ecurinë konkrete të zbatimit të projektit, në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratën përkatëse me MIE-n. Në këtë kuadër, vlerësohet e nevojshme që shoqërisë t’i kërket të paraqesë informacion dhe dokumentacion i detajuar mbi gjendjen aktuale dhe afatet e planifikuara sipas planit të zbatimit të projektit, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë me detyrimet e saj kontraktuale dhe kushtet e licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 8.8 mw, me

vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 125, datë 24.6.2025

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1497/10 prot., datë 16.6.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:



Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për licencim

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. paraqiti, më 10.4.2025, kërkesën për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 84, datë 24.4.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Në datat 25.4.2025 dhe 26.4.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit dhe deri më datë 5.5.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë pasur të tilla.

3. Dorëzimi i dokumentacionit dhe kërkesës për shtyrje të afateve

- Më datë 5.5.2025, shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. dorëzoi pranë ERE-s, përmes *email*-eve të protokolluara dhe në formë fizike, dokumentacion plotësues lidhur me aplikimin për licencim.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në ERE dhe korrespondencës me shoqërinë, kjo e fundit, më datë 19.0.2025, ndër të tjera, kërkoi disa ditë shtesë për dorëzimin e dokumentacionit të mbështetjes financiare, me argumentin se ishte në proces sigurimi të tij.

4. Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Në vijim të kërkesës së shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k., e paraqitur me *email*-in e datës 15.5.2025 dhe protokolluar në ERE me nr. 1497/6 prot., datë 19.5.2025, për shtyrje të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të mbështetjes financiare, me vendimin nr. 105, datë 23.5.2025, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

- Në vijim të njoftimit të këtij vendimi, përmes shkresës nr. 1497/9 prot., datë 3.6.2025, rezulton se shoqëria ka dorëzuar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit, përmes shkresës së protokolluar me nr. 1497/8 prot., datë 8.6.2025, nga shqyrtimi i të cilit mbetet ende për t’u sqaruar çështja e strukturës organizative të kompanisë dhe mbështetja financiare.

5. Shtyrja e afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së

Shqipërisë”, Bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të përditësojë informacionin/dokumentacionin në lidhje me strukturën organizative dhe mbështetjen financiare.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria duhet të përditësojë në ERE informacionin/ dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 126, datë 24.6.2025

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË
BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;



nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 dhe të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1496/9 prot., datë 16.6.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për licencim

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. ka paraqitur në ERE, më datë 10.4.2025, kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 83, datë 24.4.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Në datat 25.4.2025 dhe 26.4.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit dhe deri më datë 5.5.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë pasur të tilla.

3. Dorëzimi i dokumentacionit dhe kërkesës për shtyrje të afateve

- Më 5.5.2025, shoqëria dorëzoi në ERE dokumentacion shtesë për aplikimin, si në mënyrë elektronike ashtu edhe fizike. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në ERE dhe korrespondencës me shoqërinë kjo e fundit më 19.5.2025, dorëzoi planin e biznesit të përditësuar dhe kërkoi disa ditë shtesë për dorëzimin e dokumentacionit financiar.

4. Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Në vijim të kërkesës së shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k., me e-mail-in e datës 15.5.2025, protokolluar në ERE me nr. 1497/6 prot., datë 19.5.2025, për shtyrje të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të mbështetjes financiare, me vendimin nr. 104, datë 23.5.2025, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

- Në vijim të njoftimit të këtij vendimi, përmes shkresës nr. 1497/9 prot., datë 3.6.2025, rezultoi se shoqëria ka dorëzuar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit, përmes shkresës së protokolluar me nr. 1497/8 prot., datë 8.6.2025, nga shqyrtimi i të cilit mbetet ende për t’u sqaruar çështja në lidhje me strukturën organizative, mbështetjen financiare dhe disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit.

5. Shtyrja e afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të përditësojë informacionin/dokumentacionin në lidhje me strukturën organizative, mbështetjen financiare dhe disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria duhet të përditësojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 127, datë 24.6.2025****MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “PARISOL” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të, ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1628/4 prot., datë 17.6.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Parisol’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “Parisol” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1628 prot., datë 28.4.2025, ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për vendosjen barrës siguroese mbi kuotat e saj si mjet për të garantuar shlyerjen e detyrimit ndaj bankës “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Parisol” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 220, datë 23.10.2024.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria, me shkresën nr. 1628/1

prot., datë 13.5.2025, ERE i ka evidentuar shoqërisë informacionin /dokumentacionin e konstatuar të munguar në këtë aplikim, i cili konsiston në: depozitimin e ekstraktit historik të regjistrit tregtar të të licencuarit, vendimin e organeve drejtuese për vendosjen e kuotave/aksioneve si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve, parashikimin e rishikimit/çbërjes së kontratave në rast të mos marrjes së miratimit nga ERE si dhe bërjen me dije nëse ka pasur vendimin gjyqësor për vendosjen e kuotave të shoqërisë (depozitimin e tij nëse ka).

- Shkresa u kthye nga shërbimi postar me shënimin “Objekt i pakërkuar” ndaj ERE-s nëpërmjet e-mail-it protokolluar me nr. 1628/2 prot., datë 22.5.2025, i kërkoj shoqërisë të rakordojë / saktësojë adresën e dhënë si dhe të depozitojë dokumentacionin e kërkuar brenda afateve.

3. Seanca dëgjimore dhe dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Me e-mail-in e datës 22.5.2025, shoqëria konfirmon marrjen e njoftimit si dhe bëri me dije se adresa e shoqërisë është e saktë, por gjithsesi do kryejë verifikimet e nevojshme me postën shqiptare në lidhje me problematikën e ndodhur.

- Me shkresën e protokolluara në ERE me nr. 1628/3 prot., datë 29.5.2025, shoqëria ka përcjellë të plotë dokumentacionin/informacionin e kërkuar.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënie e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Parisol” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut / aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut / aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit / eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- **Neni 5, pika 2** – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- **Neni 5, pika 4** – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.



- **Neni 5, pika 5** – shoqëria ka bërë me dije se kërkon të mos jenë të hapura për publikun kontratat e kredisë nr. 2040 rep., nr. 800 kol., datë 18.4.2025 dhe nr. 2039 rep., nr. 799 kol., datë 18.4.2025, pasi përmbajnë informacione tregtare konfidenciale të bankës e shoqërisë, përfshirë dhe të dhëna personale sensitive të përfaqësuesve të subjekteve.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- **Pika 1** – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguroese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave.

- **Pika 2** – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- **Germa “a”** – ekstrakti historik i regjistrit tregtar: Shoqëria ka depozituar në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të saj, të vulosur elektronikisht nga QKB-ja më datë 27.5.2025, nga ku rezulton se shoqëria ka NUIS dhe është regjistruar në QKB, më datë 7.1.2022. Nga shqyrtimi i këtij ekstrakti vihet re se administratori i shoqërisë është z. E. D.

- **Germa “b”** – vendimi i organeve drejtuese: Është depozituar vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Parisol” sh.p.k., datë 18.4.2025, që miraton vendosjen e barrës siguroese mbi kuotat.

- **Germa “c”** – marrëveshjet përkatëse: Janë depozituar:

- **Kontratat e kredive, nr. 2039 rep., nr. 799 kol., datë 18.4.2025 dhe nr. 2040 rep., nr. 800 kol., datë 18.4.2025**, e nënshkruar midis bankës dhe shoqërisë, ku ndër të tjera përcaktohet vendosja e barrës mbi kuotat e “Parisol” sh.p.k.;

- **Marrëveshja e barrës siguroese nr. 2045 rep., nr. 805 kol., datë 18.4.2025**, e nënshkruar midis “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. (në cilësinë e barrëmarrësit), z. M. D., shoqërisë “Aksent I&BC” sh.p.k dhe shoqërisë “Albanian General Electricity” sh.p.k. (në cilësinë e Barrëdhënëseve) si ortakë të shoqërisë “Parisol” sh.p.k., që vendos barrën siguroese mbi 100% të kuotave të shoqërisë.

- **Pika 3** – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Parisol” sh.p.k., si mjet për

garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohej nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja e huas dhe marrëveshja siguroese janë nënshkruar me banka vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n **në rast të heqjes së barrës siguroese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.**

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “PARISOL” sh.p.k si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. (për kontratat datë 18.4.2025).

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Parisol” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohej nga këto organe.

3. Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Parisol” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime



materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 128, datë 24.6.2025

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“GREENNAT SOLAR PARK BALLSH”
SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT
NGA ERE PËR TRANSFERIMIN
(NËPËRMJET MARRËVESHJES
SIGURUESE) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, germa “b”, nenit 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1475/11 prot., datë 17.6.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GreeNNat Solar Park Ballsh’ sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj”, konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria me shkresën nr. 1475 prot., datë 8.4.2025, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 100 MW, për një afat 25-vjeçar me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier, ndryshuar me vendimin nr. 223, datë 23.10.2024.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria, ERE ka vijuar korrespondencën me shoqërinë respektivisht me shkresën nr. 1474/4 prot., datë 6.5.2025, me anë të së cilës njoftoi shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE si dhe kërkoi informacion/dokumentacion që nevojitet të plotësohet ende për këtë aplikim.

- ERE me shkresën nr. 1475/9 prot., datë 3.6.2025, ERE kërkoi në lidhje me listën e detajuar të aseteve me shumat specifike e totale të tyre, si pjesë integrale e kontratës së hipotekës/ marrëveshjes siguruese.

3. Seanca dëgjimore dhe dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1475/3 prot., datë 20.5.2025, nr. 1475/4 prot., datë 20.5.2025 dhe nr. 1475/5 prot., datë 22.5.2025, shoqëria dhe banka kanë depozituar informacion plotësues.

- Me shkresën nr. 1475/10 prot., datë 5.6.2025, shoqëria ka përcjellë të plotë dokumentacionin e kërkuar.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 4, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, si vijon:

- Neni 4, germa b – Për transferimin e aseteve të të licencuarve me kapacitet të instaluar nën 1 MW, nuk ka nevojë për miratimin e ERE. Për të gjithë të licencuarit e tjerë do të kërkohet miratimi i ERE-s për transferim të aseteve kur vlera e asetit që kërkohet të transferohet është më e madhe se 1.500.000 lekë.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:



- **Pika 1** – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera si më poshtë vijon:

- **Germa “a”** – ekstrakti historik i regjistrit tregtar: Shoqëria ka depozituar në ERE ekstraktin historik të vulosur elektronikisht në datën 19.5.2025, nga shqyrtimi i të cilit konstatohet se shoqëria ka NUIS dhe është regjistruar më 11.1.2022. Administrator i shoqërisë rezulton znj. A. M.

- **Germa “h”** – marrëveshjet përkatëse: Janë depozituar:

- **Kontratë kredie, me nr. 1687 rep., nr. 714 kol., datë 3.4.2025**, nënshkruar nga palët. Objekti i Kontratës është dhënia e një kredie me qëllim financimin e investimit në lidhje me ndërtimin e centralit fotovoltaiik me kapacitet prodhues 100 MW.

- **Marrëveshja e barrës siguruese nr. 1690 rep., nr. 717 kol., datë 3.4.2025**, për të siguruar pagimin, përmbushjen dhe shlyerjen e kredisë bankare.

- **Pika 3** – shoqëria ka bërë me dije se nuk është subjekt koncensionar, por projekti është investim privat dhe bazuar në përmbajtjen e kontratës, nuk parashikohet detyrimi për njoftim në rastin e barrësimit të aseteve/qëllimin e barrësimit ndaj nuk ka pasur korrespondencë me MIE-n, por gjithsesi ERE do ta vendosë në dijeni MIE-n pas marrjes së miratimit nga ERE.

- **Pika 4** – kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa dokumentet e tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit.

- **Pika 6** – shoqëria ka bërë me dije se kërkon që kontratat e përcjella të mos jenë të hapura për publikun, pasi vlerëson se përmbajtja e tyre ka natyrë sensitive për shkak të shifrave financiare, si dhe të dhënave personale të palëve të përfshira.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj (sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi), si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e saj ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a. (për kontratën datë 3.4.2025).

2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet fikse të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton heqjen e hipotekës dhe barrës siguruese të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

**“Totali i aktiveve materiale të shoqërisë
GreeNNat Solar Park Ballsh sh.p.k.”**

1. Panele fotovoltaike/Modeli LR5-7-2HTH, me vlerë 3,598,371.16 euro;
2. Invertera/Sung SG250HX V117, me vlerë 577,824.00 euro;
3. Strukturat e çelikut Magnelis ZM310 dhe të çelikut të galvanizuar Z100, me vlerë 993,393.60 euro;
4. Konektorë hyrës dhe dalës, matës të instalimeve, shtrëngues konektori, me vlerë 8,860.80 euro;
5. Strukturat metalike mbajtëse të inverterave Loti 1, me vlerë 35,663.00 euro;
6. DC Solar Kabëll H17272-K, me vlerë 105,775.20 euro;
7. Lidhja me rrjetin e PV impiantit 25 MW në rrjetin 35 kV dhe 6 kV të Nst TEC Ballsh, me vlerë 489,332.00 euro;
8. Furnizimi me kabina TM të stacioneve rritëse të parkut fotovoltaike, me vlerë 756,000.00 euro;
9. Kolona betoni, rrjeta teli, porta, rrjeta teli, tel lidhës, me vlerë 120,244.80 euro;
10. Punime elektrike të ndriçimit, instalimi i kamerave, me vlerë 125,413.20 euro;
11. Punime të rrethimit dhe restaurimit të magazinave në parkun fotovoltaike, me vlerë 129,069.00 euro;
12. Materiale për tokëzimin, me vlerë 14,361.60 euro;
13. Kabllo TU, me vlerë 115,095.60 euro;
14. Tub korogato, me vlerë 4,306.80 euro;
15. Kanale dhe kabllo 6 kV për lidhjen e kabinës 2, me vlerë 28,000.00;
16. Kanale dhe kabllo 35 kV për lidhjen e 3 kabinave 35 kV, me vlerë 170,000.00;
17. Kanalet dhe kabllot 0.8 kV për lidhjen e inverterave dhe kabinat elektrike, me vlerë 182,676.00 euro;
18. Platformat e betonit montimin e strukturave, me vlerë 1,218,830.00 euro;
19. Betoforma, bazamentet e strukturës së projektit “Greennat Solar Park 100” mw, me vlerë 12,562.80 euro.

Në total rezultojnë 8,685,780 euro.

**VENDIM
Nr. 129, datë 24.6.2025****MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 87,
DATË 24.4.2025 “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR HEQJEN E
LICENCËS NR. 129, SERIA PV11K NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË
SHOQËRISË ‘SELISHTË’ SHPK”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 7, 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1246/4 prot., datë 19.6.2025, të grupit të punës “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.4.2025 ‘Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Selishte’ sh.p.k.’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 87, datë 24.4.2025, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selishte” sh.p.k., për arsye të mosshlyerjes në afat të pagesës rregullatore për vitin 2024, si dhe të mosdepozitimit të ndonjë dokumenti apo sqarimi lidhur me këtë mospërmbushje.

- Me shkresën nr. 1335/1 prot., datë 30.4.2025, shoqëria është njoftuar për vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87/2025, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi. Një kopje e skanuar e kësaj shkrese i është dërguar shoqërisë dhe me postë elektrike në adresën e saj të e-mail-it.



- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.4.2025, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë, 26.5.2025, ndaj dhe afati 30-ditor vlerësohet të fillojë nga kjo datë.

- Pasi nga shoqëria nuk rezultoi të ishte kryer pagesa apo depozituar përgjigje pas vendimit të Bordit, u realizua një komunikim telefonik, gjatë të cilit përfaqësuesi konfirmoi marrjen e njoftimit dhe njohjen e detyrimit, duke sqaruar se për shkak të vështirësive financiare pagesa nuk është kryer në afat. Subjekti u angazhua për përmbushjen e detyrimit, ndërsa ERE bëri me dije se pagesa duhet të realizohet brenda afatit të përcaktuar.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (*statement*) të ERE-s rezulton shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj më datë 3.6.2025, brenda afatit 30-ditor të publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 87/2025, për fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë.

- Në nenin 9, germa “a” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, parashikohet, se: *me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës.*

- Në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.*

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë “Selishte” sh.p.k. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se janë zhdukur kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk

ekziston më. Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.4.2025.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.4.2025, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selishte” sh.p.k.”.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.4.2025.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë

